



Shoqata "Gender Paqe Siguri"

STRATEGJIA

5 vjeçare 2023 - 2027

Shoqata « Gender Paqe Siguri »

DURRËS, 2023



Ky publikim është bërë nga “Shoqata Gender Paqe Siguri” – ish – Shoqata e Grave me Probleme Sociale”, me mbështetjen financiare të AWEN nëpërmjet fondeve të Qeverisë Suedeze, SIDA-s, në kuadër të projektit “Qendra sociale për gra dhe vajza, Durrës”, zbatuar nga “Shoqata Gender Paqe Siguri”. Opinionet e shprehura në këtë studim janë të autorëve dhe nuk shprehin domosdoshmërisht pikëpamjet e AWEN dhe SIDA

Shoqata Gender Paqe Siguri

Adresa: L.2, Rr “Sefer Efendi”, Tel: +355 52 234 600,

www.siguria-paqja.al

e-mail: shoqatagrave@yahoo.com

gendasocialedr@yahoo.com

TABELA E PËRMBAJTJES

Falenderime.....	4
LISTA E SHKURTIMEVE	5
ORGANOGRAMA E SHOQATËS.....	6
Vizioni	6
HYRJE	11
1.1 Përshkrim i shkurtër i strategjisë	12
1.2 Parimet mbi të cilat mbështetet Strategjia	13
1.3 Situata e përgjithshme e grave dhe vajzave.....	16
II. METODOLOGJIA PËR HARTIMIN E STRATEGJISË	21
2.1 Metodologjia për mbledhjen e të dhënave.....	21
2.1.1 Analiza e dokumentacionit	21
2.1.2 Fokus grupet	24
2.1.3 Intervistat	26
2.1.4 Analiza e të dhënave	26
III. STRATEGJIA E SHOQATËS.....	27
3.1 Historiku i shoqatës	27
3.2 Vizioni strategjik	28
3.3 Qëllimet strategjike	28
3.4 Objektivat strategjike	29
IV. NDËRHJRJET	30
4.1 Veprimtaritë.....	30
4.2 Bashkëpunimi me partnerët	32
4.3 Agazhimi i Shoqatës “Gender, Paqe e Siguri” për mjedisin	33
V. PLANI PËR NGRITJEN E FONDEVE	35
VI. BUXHETI	42

Falenderime

Hartimi i kësaj strategjie dhe plan veprimi është një përpjekje e përbashkët e të gjithë aktorëve të përfshirë në zbatimin e projektit *“Qendra sociale për gra dhe vajza, Durrës”*, të zbatuar nga *“Shoqata Gender Paqe Siguri”*, me mbështetjen financiare të AWEN nëpërmjet fondeve të Qeverisë Suedeze, SIDA-s. Në hartimin e këtij dokumenti strategjik për zhvillimin e misionit të shoqatës dhe përmbushjen e qëllimeve të saj ndihmuan anëtarët e shoqatës në nivele të ndryshme angazhimi, që prej anëtarësisë së thjeshtë e deri tek bordi drejtues i shoqatës.

Gjithashtu një ndihmesë të çmuar dhanë edhe gratë përfituese të projekteve në nivel lokal dhe kombëtar.

Dhe në fund nga radha por jo nga rëndësia duam të falenderojmë ata të cilët me anë të mbështetjes së tyre financiare, kanë bërë të mundur vënien në jetë të qëllimeve dhe objektivave të shoqatës, donatorët tanë në 5 vitet e fundit, AWEN - Sida , UN Women Albania, Dimes Foundation, Swiss Contact/ Gizz, Ambasada Hollandeze dhe Ambasada Kanadeze.

Për mbledhjen dhe përpunimin e opinioneve të bashkëpunëtorëve të shoqatës dhe për hartimin në formë dokumenti të strategjisë pesë-vjeçare kontribuoi në mënyrë të veçantë ekspertja e hartimit të strategjisë dhe planit të veprimit, Edlira Ngjeçi dhe Drejtorja ekzekutive e Shoqatës Bajana Çeveli.

Së fundi, ne dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë dhe falenderojmë SIDA-s e cila nëpërmjet fondeve të Qeverisë Suedeze që mundësoi financiarisht këtë projekt.

Bajana Çeveli
Drejtoresha Ekzekutive

LISTA E SHKURTIMEVE

AWEN	Rrjeti për Fuqizimin e Grave Shqiptare
BE	Bashkimi Evropian
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave
DHSBGJ	Dhuna seksuale dhe me bazë gjinore
FA	Forcat e Armatosura
FBGJ	Fondi për Barazi Gjinore
GPS	Gratë, Paqja dhe Siguria
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Ndhmës së Trajnimit të Hetimit Kriminal
INSTAT	Instituti Kombëtar i Statistikave, Shqipëri
KSKB	Këshilli i Sigurisë së Kombeve të Bashkuara
MB	Ministria e Brendshme
MM	Ministria e Mbrojtjes
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OJF	Organizata jo - fitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
PNUD	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
QSH	Qeveria e Shqipërisë
RKSKB	Rezoluta e Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara
SIDA	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar
SHGPS	Shoqata Gender Paqe Siguri
UN Women	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore & Fuqizimin e Grave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

ORGANOGRAMA E SHOQATËS

Qëllimi i Shoqatës Gender Paqe Siguri është:

- ❖ Mbrojtja e të drejtave të grave si pjesë e të drejtave njerëzore
- ❖ Rritja e imazhit publik të gruas si dhe përfaqësimit të saj në politikë dhe jetën publike
- ❖ Zhvillimi i alternativave dhe mundësive me qëllim forcimin e statusit të gruas në komunitet.

Vizioni

BARAZI, INTEGRIM DHE PAQE

Profili i organizatës dhe historia e saj

Shoqata Gender Paqe Siguri (ish - Shoqata e Grave me Probleme Sociale) është një organizatë jofitimprurëse, e themeluar në vitin 1999, që operon në Qarkun e Durrësit. Ajo synon të promovojë barazinë gjinore në shoqëri dhe të mbrojë të drejtat e grave të marginalizuara në këtë rajon dhe në përgjithësi të vendit. Dhuna në familje, barazia gjinore, siguria dhe paqja për gratë, pjesëmarrja aktive e grave në vendimmarrje, si dhe integrimi i komuniteteve të marginalizuara të zonave informale në shoqërinë kryesore, janë çështjet kryesore në fokusin e SHGPS.

Gjatë dy dekadave, Shoqata e Gender Paqe Siguri ka avokuar dhe lobuar për përmirësimin e kornizës ligjore, institucionale dhe të politikave në lidhje me të drejtat e grave në Shqipëri, si dhe duke nxitur autoritetet qeveritare për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të grave dhe promovimin në nivel qendror dhe lokal. Iniciativa konkrete për lobim dhe avokim në lidhje me zhvillimin e komunitetit, me një fokus specifik në forcimin e statusit të grave në shoqëri, ka qenë një fokus i rëndësishëm i SHGPS.

SHGPS gjithashtu ka mbështetur viktimat e dhunës në familje dhe ata që janë në rrezik me shërbime të drejtpërdrejta, duke përfshirë: shërbime psiko-sociale, ligjore dhe mjekësore, si dhe duke siguruar mundësi të ri-integrimit, përfshirë mundësi punësimi, mundësi të krijimit të të ardhurave etj.

Duke filluar nga viti 2014, Shoqata gjithashtu është përqëndruar në sjelljen e çështjeve të Grave, Paqes dhe Sigurisë në axhendën e autoriteteve qeveritare. Gjatë viteve të fundit, Shoqata, me mbështetjen e Fondit të Grave të Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore, ndihmoi në hartimin e një Plani Kombëtar të Veprimit (PKV) mbi rezolutën e Këshillit të Sigurimit të KB (UNSCR) 1325 mbi Gratë, Paqen dhe

Sigurinë, i cili u miratua në shtator 2018. SHGPS mbeshteti gjithashtu krijimin e një koalicioni, "Gratë, Paqja dhe Siguria në Shqipëri", e përbërë nga 31 organizata lokale.

Arritjet kryesore të SHGPS:

Arritjet kryesore të SHGPS gjatë 23 viteve të historikut të saj, si më poshtë:

- ↳ Në vitin 2001, hapja e Qendrës së parë Këshilluese për Gra dhe Vajza në Qarkun e Durrësit. Qendra e Këshillimit e mundësuar me mbështetjen financiare të NPA ofronte këshillim ballë për ballë për gra dhe vajza, këshillime nëpërmjet linjes telefonike, ndihmë juridike etj.
- ↳ Në vitin 2001, SHGPS hapi Qendrën ditore për të moshuar, një projekt i mbështetur nga Banka Botërore. Shërbimet kryesore të ofruara: shërbimet mjekësore, mbështetja psikologjike, shërbimi në komunitet (Kurse profesionale, festimi i ditëlindjeve etj).
- ↳ Në Porto Romano, një zonë joformale e qytetit të Durrësit, në 2004 u hap një Qendër Komunitare "Shpresa", si degë e Shoqatës së Grave me Probleme Sociale.
- ↳ Në vitin 2007, në kuadër të Projektit COOSLA, i mbështetur nga BE, COOSS Marche, Bashkia Durrës dhe Drejtoria Arsimore Rajonale u hap Qendra Komunitare për Gra dhe Vajza në zonën informale të Spitalles. Kjo Qendër Komunitare ka shërbyer si një burim informacioni për të rinjtë dhe gratë, një mundësi për t'u informuar për problemet e ndryshme sociale në lidhje me gratë dhe të rinjtë, një strukturë për shërbime psikosociale për grupet e të rinjve dhe grave në nevojë, një strukturë me përvojë dhe aftësi në hartimin dhe zbatimin e programeve rinore, si dhe një strukturë informacioni dhe komunikimi për shëndetin riprodhues, AIDS/STD dhe përdorimin e drogave.
- ↳ Në vitin 2008, me mbështetjen e programit të USAID-it është bërë e mundur hapja e Zyrës së Parë Gjinore si pjesë e Bashkisë Durrës. Hapja e kësaj zyre ishte e para që u hap në Shqipëri dhe shërbeu si model për hapjen e zyrave të tjera të këtij lloji në komunat e Qarkut Durrës.
- ↳ Krijimi i dy inkubatorëve artizanalë në dy fshatra turistike (2012 - 2013), përkatësisht: në Tushemisht/Pogradec dhe Voskopojë/Korca. Inkubatorët artizanë ofrojnë mundësi për gjenerimin e të ardhurave për gratë lokale, duke mbajtur gjallë trashëgiminë kulturore të këtyre zonave.
- ↳ Në vitin 2014, SHGPS hapi Zyrën e parë Rajonale Gjinore si pjesë e Institucionit të Qarkut Durrës. Hapja e kësaj zyre është rezultat i punës dhe bashkëpunimit të gjatë të Shoqatës së Grave me Probleme Sociale, me Këshillin e Qarkut Durrës në adresimin e çështjeve të barazisë gjinore dhe dhunës në familje në Qark;
- ↳ Ofrimi i kurseve profesionale dhe mundësive të punësimit për gratë në nevojë. Në vitin 2018, në kuadrin e thirrjes së 1-të të projektit C4EE, SHGPS ngriti një Zyrë Karriere të vendosur në ambientet e Qendrës Komunitare për Gratë dhe Rininë (Spitalle).
- ↳ Në vitin 2018, Hartimi i Planit Kombëtar të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurisë të KB për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në emër të Qeverisë së Shqipërisë, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme, si dhe përfaqësuesit e autoriteteve lokale, partnerët ndërkombëtarë dhe koalicioni i shoqërisë civile "Koalicioni i Grave të Paqes dhe Sigurisë".

↪ Nw vitin 2019 dhe 2021, u realizua monitorimi i Planit të Parë Kombëtar të Veprimit për zbatimin e kësaj Rezolutive, duke dalë më dy Raport Monitorimi lidhur me këtë.

Gjatë viteve, SHGPS numëron një numër të lartë të projekteve të implementuara të mbështetur nga donatorë të ndryshëm, si më poshtë:

1999- SNV, IRC, Act donation
2000- PNUD, World Bank
2001- Albanian Development Fund, NPA, SOROS, MILENIUM CONTACT
2002- Dutch Embassy, Kvinna Till Kvinna (KTK, Swedish foundation)
2003- Norwegian Embassy, Kvinna Till Kvinna, American Embassy
2004- SOROS, KTK, Norwegian Embassy
2005- World Bank, KTK, SOROS
2006- SOROS, American Embassy, KTK
2007- IPA, Balkan Trust, KTK
2008- UNFPA, IPA, SOROS, Global Fund, KTK, Swiss Embassy;
2009- EU, SOROS, KTK;
2010- EU, KTK, SOROS;
2011- American Embassy, KTK, EU;
2012- KTK, The national agency for the development of civil society (AMSHC), EU;
2013- KTK, EU- Cross Border, AMSHC, SWISS CONTACT, EU IPA;
2014- KTK, EU IPA, AMSHC, SWISS CONTACT;
2015- SWISS CONTACT, EU IPA, Agency for free legal assistance for the victims of domestic violence, Operation 1325;
2016- SWISS Contact, AWEN, FGE UN Women, Dutch Embassy;
2017- SWISS Contact, AWEN, Save the Children, Dutch Embassy;
2018- SWISS Contact, AWEN, Save the Children, FGE UN Women;
2019-SWISS Contact, SWISS Contact-GIZ, AWEN, RCC.
2020 - SWISS Contact, AWEN, FGE UN Women Albania,
2021 - SWISS Contact, AWEN, FGE UN Women, Dutch Embassy
2022 - AWEN/ Sida, UN Women Albania
2023 – Awen/ Sida, Dimes Foundation, Un Women Albania, Ambasada Kanadeze

Ekspertiza jonë

Shoqata Gruaja Paqja Siguria ofron ekspertizën e saj në këto drejtime, si më poshtë:

Advokim dhe lobim për përmirësimin e kornizës ligjore, institucionale dhe të politikave në lidhje me të drejtat e grave në Shqipëri, si dhe nxitjen drejt progresit të autoriteteve qeveritare për të siguruar mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave në nivelin e vendit.

Rritja e aftësive të profesionistëve dhe trainimi për të siguruar një mekanizëm funksional dhe mbrojtës shoqëror për viktimat e dhunës në familje;

Shërbime mbështetëse direkte për gratë në nevojë, duke përfshirë si më poshtë:

Shërbime psiko-sociale për grupe të marginalizuar të grave, të tilla si: gra të divorcuara, gra të veja, viktima të dhunës në familje dhe trafikim si dhe gra të papuna. Këto shërbime ofrohen nga: psikologë klinikë dhe punonjës socialë.

Shërbime juridike - këshillime dhe ndihmë juridike për gratë që jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike dhe u paraprijnë proceseve gjyqësore, siç janë: dhënia e urdhrit të mbrojtjes në rastet e dhunës në familje, procedurat e divorcit dhe vlerësimi psiko-emocional i fëmijët gjatë proceseve gjyqësore të divorcit. Këto shërbime ofrohen nga avokatët.

Ndërtimi i Kapaciteteve Profesionale - kurse profesionale për grupe në nevojë, veçanërisht për gra dhe të rinj të papunë. Këto kurse synojnë të rrisin mundësitë e grupeve të synuara në lidhje me integrimin e tyre në tregun e punës, mundësitë për punësim si dhe mundësitë e start-upeve duke ofruar mbështetje për vetëpunësimin dhe për ngritjen e bizneseve.

Krijimi i mundësive për krijimin e të ardhurave për gratë në nevojë, d.m.th: krijimi i inkubatorëve artizanal, biznesit shoqëror, bizneseve fillestare, etj;

Partnerët tanë

SHGPS ka bashkëpunim të vazhdueshëm me:

Strukturat shtetërore në nivel qendror: Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

Strukturat në nivel lokal: Qarku, Prefekturë, Bashki, komuna të qarkut Durrës, Tiranë, Korçë, Elbasan, Kukës, Shkoder, Berat, Vlorë; Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social, Zyra Rajonale e Punësimin, Drejtoria Rajonale Arsimore, Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik, Drejtoria Rajonale e Policisë.

Albanian Women Empowerment Network (AWEN), Psycho-Social Centre "Vatra"; Counselling Centre for Women and Girls, Tirana, Women Forum, Elbasan; "Me, the Woman" Centre, Pogradec; Gender Alliance, Tirana; Argitra – Vizion, Peshkopi, "Jona" organization, Sarande; "Women to Women", Shkoder.

Koalicioni Gruaja Paqja Siguria: Qendra Vatra, Agrita Vizion, Shoqata Jona, Unë Gruaja, Gruaja tek Gruaja, Klubi Social, Forumi I Gruas Elbasan, Qendra "Fëmijet Sot", AWEN, SH.P.G.F, Komiteti I Helsinkit, Gruaja Në Fokus, SH. Për Zhvillim Psiko-Social-Kulturor të Fëmijëve dhe të rinjve, Të ndryshëm të barabartë, Kongresi Rinor, Mary Word Laureto, Në Dobi të Femrës, Komuniteteve, Qendra Konsumatori Shqiptar, Fokus - Në ndihme të fëmijeve, Atom, CSDC, Shoqata e Gazetarve, Dev-Aid, Për Ju nëna dhe

Femije, Dora Prindërore, E Shkuara për të ardhmen/Past for Future, Përkrahje për të Rinjtë, Fëmijëve Jetim, IPSED, Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare.

Organizata ndërkombëtare: OSBE, Operation 1325, UN Women FGE, Ambasada Kanadeze.

"Koalicioni për Rezolutën 1325" i emërtuar "Gruaja Paqe Siguri", përbëhet nga 31 organizata prestigjioze të shoqërisë civile shqiptare. Ky koalicion aktivizohet prej tre vitesh në zbatimin siç duhet të rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe të Planit Kombëtar të Veprimit të qeverisë shqiptare përmes monitorimit, advokimit, dhe lobimit për zbatimin e tyre si dhe ndërgjegjshimin publik për çështjet e sigurisë e paqes së grave.

Në kuadër të implementimit të projektit, për t'i dhënë frymë konkrete zbatimit të Planit të Veprimit lidhur me Rezolutën në terrenin e organizatave anëtare të Koalicionit, si dhe për të patur një udhërrëfyes informativ për to, ekspertët e fushës hartuan Strategjinë Orientuese, e cila ka ardhur si fryt edhe i punës së organizatave në hartimin e strukturës dhe përmbajtjes së tij. Ky dokument është guida udhërrëfuese e cila i hap rrugë realizimit të misionit dhe vizionit të Koalicionit në monitorimin e Planit të Veprimit si dhe aspekteve të tjera adresuar sigurisë së grave në vendin tonë. Ky dokument strategjik siguron ecurinë konkrete të veprimtarisë së Koalicionit në kuadër të monitorimit të implementimit të këtij plani veprimi në vendin tonë.

Emri i Organizates	Vendi
1. Shoqata Gratë Siguri Paqe	Durrës
2. Qendra Vatra	Vlorë
3. Agrita Vizion	Peshkopia
4. Shoqata Jona	Saranda
5. Unë Gruaja	Pogradeci
6. Gruaja tej Gruaja	Shkodra
7. Klubi Social	Korcë
8. Forumi I Gruas Elbasan	Ebasan
9. Qendra "Femijet Sot"	Tirana
10. AWEN	Tirana
11. SH.P.G.F	Tirana
12. Komiteti I Helsinkit	Tirana
13. Gruaja në Fokus	Durrës
14. SH. Per Zhvillim Psiko-Social-Kulturor te Femijeve dhe te rinjve	Ebasan
15. Te ndryshem te barabarte	Tirana
16. Kongresi Rinor	Tirana
17. Mary Word Laureto	Tirana
18. Ne Dobi te Femrës, Komuniteteve,	Tirana

shtresave ne nevoje dhe personave me aftesi te kufizuar	
19. Qendra Konsumatori Shqiptar	Durrës
20. Fokus - Ne ndihme te femijeve	Tirana
21. Atom	Peshkopia
22. CSDC	Shkodër
23. Shoqata e Gazetarve	Elbasan
24. Dev-Aid	Tirana
25. Per Ju nena dhe Femije	Kukës
26. Dora Prinderore	Korca
27. E Shkuara per te ardhmen/Past for Future	Korca
28. Perkraheje per te Rinjte	Korca
29. Femijeve Jetim	Korca
30. IPSED	Tirana
31. Qendra Kombetare per Sherbime Komunitare	Tirana

Hapat e Planit të Hartimit të Planit Strategjik 2023-2027 SHGPS

Ky plan është produkt i i punës së një sërë aktorësh dhe inputeve të mbledhura prej tyre. Procesi i përgatitjes së këtij dokumenti kaloi në disa hapa si:

Hapi i parë:

Organizimi i fokus grupeve dhe intervistave mbi veprimtarinë e organizatës ndër vite

Hapi i dytë:

Workshopi i Planifikimit Strategjik i cili u mbajt me stafin dhe anëtarë të tjerë të Shoqatës.

Hapi i tretë:

Draftimi i Planit Strategjik nga Ekspertja dhe grupi i punës.

Hapi i katërt:

Paraqitja e draftit të Planit Strategjik për rishikim pjesëmarrësve në workshop dhe Bordit të shoqatës. Reflektimi i rekomandimeve dhe sygjerimeve të tyre në draftin final.

Hapi i pestë:

Plani Strategjik dhe Fundraising, prezantimi i tij ndaj bashkëpunëtorëve lokale, donatorëve, përfituesve si dhe komunitetit.

HYRJE

1.1 Përshkrim i shkurtër i strategjisë

Që prej vitit 1990 e deri më sot, ndryshimet ekonomike dhe shoqërore i kanë ekspozuar vajzat dhe gratë ndaj rrezikut të përjashtimit social. Ristrukturimi ekonomik pas përmbyesjes së regjimit socialist solli papunësi masive të fuqisë punëtore dhe gratë u prekën më shumë se sa burrat nga ky fenomen. Pabarazia ekonomike mes burrave dhe grave u thellua duke rritur shkallën e varfërisë, kryesisht për femrat, e cila i vuri gratë nën varësinë ekonomike të bashkëshortëve. Për të zbutur efektet e varfërisë, shteti krijoi programin e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë duke ofruar ndihmë të përmuajshme në para. Përveç shtetit, një rol të rëndësishëm në plotësimin e nevojave për shërbime sociale të grupeve të ndryshme kanë luajtur organizatat e shoqërisë civile, partnerët strategjikë, donatorët dhe organizmat ndërkombëtarë. Gjithashtu, janë rritur edhe kompetencat e pushtetit vendor, për t'iu përgjigjur nevojave të komunitetit.

Shoqata Gender Paqe Siguri ka dhënë ndihmesën e vet në ofrimin e shërbimeve në nivel komunitar, atje ku janë përfituesit dhe lindin nevojat e tyre, për të mbështetur dhe ndihmuar gratë me probleme sociale, familjet e tyre dhe komunitetin ku ato jetojnë. Ndihma e shoqatës ndaj grave ka pasur si objekt kryesor synimin që gratë të jenë më të pavarura ekonomikisht dhe të përfshihen si të barabarta me burrat në tregun e punës dhe në vendimmarrjen politike në të gjitha sferat e shoqërisë. Ndër të tjera, në kuadër të implementimit të projektit “Rezoluta 1325, të drejtat e grave nga koncepti në realitetin shqiptar” paraqiti nevojën për fokusin e Shoqatës në aspekte të menaxhimit të axhendës “Gruaja, Paqja, Siguria”. Në mënyrë që të vazhdojë punën për fuqizimin e grave me probleme sociale, shoqata ka hartuar këtë strategji për pesë-vjeçarin e ardhshëm, për vitet 2023-2027. Shoqata Gender Paqe Siguri, e emërtuar si “Gender, Paqe, Siguri” zotohet që në kuadër të nevojave të arritjes së barazisë gjinore në komunitetet tona, me në vëmendje të veçantë në vijimin e punës për axhendën “gruaja, paqja, siguria” duke e evidentuar si një dosmosdoshmëri të përmirësimit të situatës së barazisë gjinore në komunitetet tona.

Synimi i Strategjisë është të sigurojë një politikë të qartë afat-mesme për fuqizimin e grave, në fusha që lidhen me fuqizimin ekonomik, me përfaqësimin politik si dhe luftën kundër dhunës në familje. Kjo **Strategji synon rritjen e kapacitetit të shoqatës:**

- për të rritur përfaqësimin politik të grave në procesin e vendimmarrjes publike;
- për fuqizimin ekonomik të grave në nevojë;
- për të ofruar shërbime sociale me bazë komunitare për gratë në nevojë;
- për pakësimin e dukurisë së dhunës në familje;
- për përfshirjen e grave në çështje të paqes dhe sigurisë.

Strategjia parashikon **masa për vlerësimin e nevojave dhe planifikimin e rritjes së kapacitetit të shoqatës**, ku përfshihet edhe bashkëpunimi me aktorët që kanë përgjegjësi për mbrojtjen shoqërore të grave në nevojë, për fuqizimin ekonomik të tyre dhe rritjen e përfaqësimit politik në organet vendimmarrëse. Ndër të tjera, metodologjitë e ngritura në nivel strategjik bazohen në problematikat e identifikuar gjatë punës 23 vjeçare të shoqatës, si dhe specifikisht atyre të identifikuar gjatë pesë-vjeçarit të fundit. Së bashku me metodologjinë, objektivat dhe plani financiar mbeten shtylla të rëndësishme të kësaj strategjie.

Buxheti për mbulimin e objektivave të Strategjisë përballohet nga fondet e parashikuara në buxhetin pesë-vjeçar 2023-2027, nga projekte të përbashkëta me qeverinë dhe donatorë. Rritja e kapaciteteve humane, monitorimi dhe vlerësimi i objektivave të strategjisë janë objektiva madhore që trajtohen në këtë strategji. Kjo strategji sjell si risi në konceptimin e saj dhe elementin e SDG Sustainable Development Goals në kuadër të Axfordës së Kombeve të Bashkuara në përcaktimin e elementëve metodologjikë si dhe për efekt të qendrueshmërisë së menaxhimit të projekteve.

1.2 Parimet mbi të cilat mbështetet Strategjia

Strategjia është e ndërtuar mbi disa parime që rrjedhin nga misioni i shoqatës për të zgjidhur problemet sociale me të cilat përballen gratë në të gjithë vendin. Në punën e saj, shoqata mbështetet edhe në parimet e shprehura në dokumentet më të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare si:

Qeveria shqiptare ka ndërmarrë përpjekje serioze për të siguruar pajtueshmërinë e gjyqësorit shqiptar me standardet ndërkombëtare dhe ka nënshkruar dhe ratifikuar disa marrëveshje ndërkombëtare lidhur me anti-diskriminimin dhe drejtpërdrejtë ose tërthorazi ndaj dhunës në familje. Konventat dhe deklaratat ndërkombëtare kanë ofruar një qasje dhe kornizë ligjore në lidhje me trajtimin e dhunës në familje, një pjesë e konsiderueshme e të cilave është dhuna kundër grave.

Republika e Shqipërisë është pjesë e konventave të mëposhtme të KB dhe KE:

- Deklarata Universale e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (DUDNJ), miratuar në 10 dhjetor 1948 dhe protokollet e saj, e cila shpalli konceptin e barazisë ndërmjet qënieve në të gjithë botën.
- Konventa Ndërkombëtare e OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, miratuar në 1966 dhe ratifikuar më 4 tetor 1991.
- Konventa e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave³ (KEGJFDG) miratuar në 1979, ratifikuar më 11 maj 1994 dhe Protokollin e saj Opsional (1999). Kjo Konventë është konsideruar si "një projekt-ligj ndërkombëtar i të drejtave për gratë". Ajo e përcakton diskriminimin në një mënyrë shumë thelbësore, duke e bërë të qartë se gratë kanë të drejtën e gëzimit të plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave të tyre njerëzore.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF) miratuar në 1989 dhe Protokollet e saj Opsionale (2000), u ratifikua më 27 shkurt 1992. Kjo konventë siguron autorizim të qartë për shtetin për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e dhunës në në familje, si dhe përcakton rolin e saj si arbitër përfundimtar i mirëqenies së fëmijëve brenda vendit.
- Konventa e OKB-së kundër Torturës dhe Trajtitimit ose Ndëshkimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar, ratifikuar më 11 Maj 1994.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2006), u ratifikua në dhjetor 2012;
- Karta Sociale Europiane (ETS Nr. 35, 1961, erishikuar në 1996, ETS Nr.163),

³ Njohur ndryshe si CEDAW

- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolli i saj, ratifikuar më 10 shkurt 1996.
- Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruar ratifikuar më 10 shkurt 1996.
- Konventa e Këshillit të Europës mbi Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual (CETS Nr. 201, 2007);
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje (e njohur si Konventa e Stambollit) në prill të vitit 2011. Kjo Konventë u ratifikua më 19 dhjetor 2011.
- Rekomandimi i Përgjithshëm Nr 19 të Komitetit CEDAË mbi dhunën kundër grave;
- Rekomandimet e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare të Këshillit të Europës: Rekomandimi (2002) mbi mbrojtjen e grave nga dhuna;
- Rekomandimi (2007) mbi standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore;
- Rekomandimi (2010) mbi rolin e burrave dhe grave në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve dhe vendosjen e paqes, dhe rekomandime të tjera përkatëse;
- Rekomandimet e Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave (CEDAË), të miratuara në vitin 2016 dhe rekomandimet në raportin e parë të vlerësimit mbi Shqipërinë, të Grupit të Ekspertëve të Këshillit të Europës, "Mbi luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO)", të publikuara më 24 nëntor 2017.
- Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Shtator të 2015. Kjo marrëveshje historike e ndërtuar mbi sukseset e Objektivave të Zhvillimit të Mijë-vjeçarit krijoi për herë të parë një kornizë veprimi universale për të zhdukur varfërinë dhe për të zvogëluar pabarazinë, duke promovuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, të bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut.

Kuadri ligjor kombëtar për dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje në Shqipëri;

- ✓ Kushtetutën e re të Republikës së Shqipërisë. (neni 18/2, nenit54/1, neni 54/3)
- ✓ Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë (neni 124/b, neni 130/a)
- ✓ Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë (neni 62)
- ✓ Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë (neni 9)
- ✓ Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"
- ✓ Ligji Nr. 9914, datë 12.5.2008 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006" Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare ", ka caktuar Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si një autoritet tjetër përgjegjës për dhunën në familje. Ligji është ndryshuar më 30.09.2010 me Ligjin nr. 10 329.
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 07.02.2011 "Për krijimin e një sistemi kombëtar referimi për viktimat e dhunës në familje dhe mënyrën e funksionimit të tij".

- ✓ *Ligji Nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për Barazinë Gjinore në shoqëri"* rregullon aspektet kryesore të barazisë gjinore në të gjitha fushat për një trajtim të barabartë ndërmjet burrave dhe grave.
- ✓ *Ligji Nr. 10 221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi"*, i cili rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë i lidhur me një sërë arsyesh joshteruese, duke përfshirë dhe gjininë.
- ✓ *Ligji Nr. 10.399, datë 17.03.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005" Për ndihmën dhe shërbimet sociale"*, sanksionet që gratë e dhunuara gjithashtu kanë të drejtë të përfitojnë pagesën e ndihmës ekonomike në rastet kur ato kanë UM/UMM,
- ✓ *Ligj Nr. 125/2020 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"*, të ndryshuar.

Dokumenta Strategjike

- Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2021-2030,
- Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, miratuar në dhjetor 2015 dhe
- Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar, miratuar në qershor 2016
- Udhëzime të Treguesve të Harmonizuar për Barazinë Gjinore dhe Statusin e Grave në Shqipëri.
- Plani Kombëtar i Veprimit për Gratë Sipërmarrëse 2014-2020
- Strategjia Kombëtare për Decentralizim 2023 – 2027
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2020 – 2023
- Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore Bashkia Durrës 2023 – 2025.

Disa nga këto parime janë:

- *Parimi i së drejtës për trajtim të ndershëm dhe mosdiskriminues*

Shërbimet ofrohen për çdo grua në nevojë, pavarësisht nga origjina, feja, mosha, aftësitë e kufizuara ose veçanësi të tjera. Çdo grua në nevojë ka të drejtën të përfitojë të njëjtën ndihmë apo shërbim pa u diskriminuar.

- *Parimi i mbrojtjes*

Të gjitha veprimet e ndërmarra në lidhje me përfituesit drejtohen nga parimi i respektimit të të drejtave të njeriut. Gratë në nevojë kanë nevoja specifike dhe duhet të gëzojnë mbrojtje të veçantë në përputhje me të drejtat dhe nevojat e tyre. Gratë kanë të drejtën e mbrojtjes nga dhuna, shfrytëzimi, abuzimi dhe varfëria.

- *Parimi i së drejtës së zhvillimit*

Ky parim nënkupton sigurimin e një mjedisi favorizues për vajzat, për t'u siguruar atyre mbijetesën dhe zhvillimin maksimal si në aspektin fizik, mendor, shpirtëror, moral, psikologjik dhe social, në përputhje me dinjitetin njerëzor.

- *Parimi i pavarësisë, autonomisë dhe respektimi i pikëpamjeve*

Gratë janë përgjegjëse për jetët e tyre. Ato duhen inkurajuar të marrin vendime për mënyrën e jetesës brenda normave që shoqëria ka vendosur. Ata duhen nxitur të shprehin opinionin e tyre dhe të ndihmohen për të ruajtur ose fituar pavarësinë e tyre. Të drejtat, dinjiteti, mendimet, pikëpamjet dhe përkatësia etnike, sociale, shëndetësore dhe fetare e grave përfituese të respektohen pa dallim.

- *Parimi i përfshirjes dhe integritetit*

Shërbimet për gratë kontribuojnë për përmirësimin e pozitës së tyre në familje dhe shoqëri si dhe i mbrojnë nga përgjashtimi social. Shërbimet garantojnë përfshirjen e grave në nevojë në aktivitete të jetës së përditshme si: në punë, vendimmarrje, kujdesin për vete dhe përfshirjen në jetën komunitare.

- *Parimi i partneritetit*

Shërbimet ofrohen në bashkëpunim me vetë gratë, si dhe me aktorët e tjerë në nivel qendror, rajonal e vendor dhe komunitetin. Bashkë me këta aktorë realizohet identifikimi, vlerësimi, planifikimi dhe zgjidhja e nevojave. Partnerë në këtë proces do të jenë organizatat e shoqërisë civile, grupet komunitare, biznesi social dhe personat me ndikim në komunitet.

1.3 Situata e përgjithshme e grave dhe vajzave

Që prej vitit 2006, autoritetet qeveritare shqiptare kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e situatës së dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke krijuar një kuadër ligjor dhe politika të lidhura me trajtimin e fenomenit si dhe me qëllim mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave. Pavarësisht faktit të progresit dhe punës së bërë në këto 17 vite, ende duhet të ndërmerren hapa të tjerë që do të ndikojnë në përmirësimin e situatës së dhunës në Shqipëri. Qeveria shqiptare ka ndërmarrë përpjekje serioze për të siguruar pajtueshmërinë e gjyqësorit shqiptar me standardet ndërkombëtare dhe ka nënshkruar dhe ratifikuar disa marrëveshje ndërkombëtare lidhur me anti-diskriminimin dhe drejtpërdrejt ose tërthorazi me dhunën në familje. Konventat dhe deklaratat ndërkombëtare kanë ofruar një qasje dhe kornizë ligjore në lidhje me trajtimin e dhunës në familje, një pjesë e konsiderueshme e të cilës është dhuna kundër grave. Strategjitë që kanë rëndësi të veçantë në kuadrin e masave kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje janë të tilla, që kanë impakt të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në parandalimin dhe luftën ndaj fenomenit dhe mbështetjen e viktimave.

Aktualisht në Shqipëri është ngritur një kuadër ligjor dhe institucional efektiv që mbron dhe i vjen në ndihmë një individi që është viktimë e dhunës në përgjithësi dhe në veçanti kur është një viktimë e dhunës në familje. Siç u pasqyrua nga të dhënat e INSTAT, prevalenca e dhunës në familjet shqiptare mbetet ende e lartë dhe gratë si viktima të dhunës në familje zënë përqindjen më të lartë në shkallë vendi krahasuar me burrat.

Në grua e cila është viktimë e dhunës në familje përballet me një sërë pasojash dhe problemesh, për të cilat ajo ka nevojë për ndihmë emergjente, aftatshkurtër dhe afatgjatë. Masat ligjore me ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës në familje përfshijnë⁴:

⁴ Raport Grevio (2017)

- Trajtimin e viktimave të dhunës nën skemën e asistencës sociale. Kjo u bë e mundur nga ndryshimet e vitit 2014 në ligjin nr.9355, datë 10.03.2005 "Për sigurimet dhe shërbimet shoqërore" (shih Ligjin nr. 47/2014), duke ofruar përfitime për viktimat e dhunës në familje, të cilat më parë nuk trajtoheshin në institucionet e mirëqenies sociale gjatë periudhës së vlefshmërisë së UM/UMM.
- Të drejtën për mbledhjen e përfitimeve të asistencës sociale në cash dhe ndryshimet në formën e ndihmës sociale, për të siguruar që gratë të aplikojnë për të. Dekreti i Këshillit të Ministrave nr. 375, datë 11 qershor 2014, ndryshoi Dekretin e Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 12.12.2012 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit të kërkuar për të marrë asistencë sociale në para në zonat pilot, duke e njohur gjithashtu këtë të drejtë edhe për gratë.
- Sigurimin e një ndihme prej 3,000 lekësh (të reja) për të gjitha përfitueset që janë viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit, të cilat marrin shërbime të mirëqenies sociale në qendrat rezidenciale publike dhe kanë mungesë të të ardhurave personale. Kjo u bë e mundur me Dekretin e Këshillit të Ministrave nr. 840, datë 3 dhjetor 2014, që ndryshon Dekretin e Këshillit të Ministrave Nr. 114, datë 31.01.2007, "Për përcaktimin e shumës së kontributeve të pagueshme nga personat e vendosur në institucionet publike të mirëqenies sociale.
- Vendosjen në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje. Kjo do të thotë se kur një viktimë e dhunës në familje identifikohet nga struktura të tilla përgjegjëse si: policia, OJF-të që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror në lidhje me dhunën në familje, ose strukturat e qeverisjes vendore përgjegjëse për të adresuar dhunën, pavarësisht nëse individi posedon një UM/UMM, individi duhet të vendoset automatikisht në ato institucione. Kjo u bë e mundur me Dekretin e Këshillit të Ministrave nr. 839, datë 3 dhjetor 2014, që ndryshon dekretin e Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 27 qershor 2012, "Për specifikimin e kriterit dhe dokumentacionit të kërkuar për praninë në institucionet e mirëqenies publike dhe jo-publike.

Sipas Raporteve të Progresit të BE-së për Shqipërinë, Shqipëria është në përputhje me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe ka ratifikuar shumicën e konventave ndërkombëtare. Strategjia dhe Plani Kombëtar i Veprimit (2021 - 2030) mbi Barazinë Gjinore u miratua në Tetor 2021. Shqipëria ka bërë përpjekje të vazhdueshme për ta bërë barazinë gjinore një pjesë integrale të planifikimit dhe buxhetimit për zhvillimin kombëtar dhe integrimin në BE, por këto ende duhet të pasqyrohen në nivelin lokal. Gratë janë të përfaqësuara në mënyrë të barabartë në qeverinë e re. Përqindja e grave parlamentare gjithashtu u rrit nga 16% në 28.5% në parlamentin e ri. Në Dhjetor 2017, Parlamenti miratoi një rezolutë mbi luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe themeloi një nën-komitet parlamentar për barazinë gjinore. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të siguruar që të gjitha strategjitë dhe politikat gjinore janë të integruara.

Ministria e Drejtësisë themeloi një zyrë të re për të koordinuar përpjekjet kundër dhunës në familje. Ekziston gjithashtu një nevojë për të siguruar një koordinim ndër-sektorial me mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve dhe antitrafikimit në nivelin lokal dhe rajonal. Që nga Dhjetori i vitit 2016, një numër kombëtar i urgjencës i financuar nga donatorët për viktimat e dhunës në familje ka funksionuar. Në përgjithësi, nevojitet më shumë punë për të siguruar që gratë të kenë qasje në drejtësi.

Sipas të dhënave të publikuara nga raporti i INSTAT "Burra dhe Gra" në Shqipëri, 2022⁵, rezultojnë se situata e dhunës ndaj grave dhe konkretisht dhuna në familje mbetet serioze. Sipas këtij raporti, në vitin 2019, në përgjithësi, 1 në 2 gra, ose 52,9% e grave pohojnë se kanë përjetuar dhunë të paktën një herë

⁵ <https://www.instat.gov.al/media/11027/burra-dhe-gra-2022.pdf>

në jetën e tyre gjatë gjithë jetës, dhe 36.6% e tyre pohojnë se aktualisht janë duke përjetuar dhunë. Sipas të dhënave të raportuara në nivel kombëtar për vitin 2021 (neni 130/a) ka një rritje të numrit total të viktimave të dhunës në familje. Në vitin 2021 janë gjithsej 1757 viktima të dhunës në familje dhuna, nga të cilat 1216 viktima femra dhe 541 viktima meshkuj, krahasuar me 1656 viktima të dhunës në familje në vitin 2020.

Në vitin 2021, kanë raportuar dhunë në familje 3.367 gra. Rastet e dhunës në familje pasqyrojnë numrin e raportimeve të bëra në polici, fenomen i cili mund të shkaktojë dhe vdekjen e personit. Qarku që zë peshën më të madhe të grave të dëmtuara është ai i Tiranës, i ndjekur nga qarku i Durrësit, Fierit dhe Vlorës. Përkatesisht 33,8 % ndaj totalit të grave të dëmtuara i përkasin qarkut të Tiranës, 16,8 % Durrësit, 9,9 % Fierit dhe 9,3 % Vlorës. Në vitin 2021, nga 61 vrasje me dashje rreth 16,4 % e tyre kanë ardhur si rezultat i vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare (neni 79/c).

Sipas Konventës së Këshillit të Evropës⁶, shërbimet që duhet të vihen në dispozicion të viktimave të dhunës në familje duhet të përmbushin standartet e vendosura në lidhje me cilësinë, aksesin dhe llojin e shërbimeve të ofruara.

Shërbimet në ndihmë të viktimave duhet të ofrohen nga shteti në bazë të tre parimeve themelore të Konventës së Këshillit të Evropës: i) parandalimi, ii) mbrojtja e viktimave dhe iii) procedimi i dhunuesve. Këto shërbime do të kryhen në bashkëpunim me OJF-të që kanë eksperiencë dhe të specializuara në fushën e dhunës në familje, apo me biznese sociale që veprojnë në fushën e ofrimit të shërbimeve sociale për këtë grup të synuar.

Konventa bën dallimin ndërmjet shërbimeve mbështetëse të përgjithshme dhe të specializuara për viktimat e DHF. *Shërbimet mbështetëse të përgjithshme* (Neni 20) i referohen “masave dhe ndihmës që ofrojnë autoritetet publike, si: shërbimet e strehimit, psiko-sociale, ligjore, shëndetësore, financiare, të arsimit si dhe shërbimet e punësimit, të cilat lehtësojnë rehabilitimin e tyre nga dhuna. *Shërbimet mbështetëse të specializuara* (Neni 22), nga ana tjetër, “janë shërbime të dedikuara vetëm për viktimat e dhunës në familje, që duhet të ofrohen nga qendra (që në pjesën më të madhe mbulohen nga OJF-të) të specializuara për ofrimin e mbështetjes dhe asistencës së përshtatur sipas nevojave të viktimave të formave specifike të dhunës ndaj grave apo të dhunës në familje dhe nuk janë të mundshme për publikun e gjerë”. Shërbimet mbështetëse të specializuara mund të jenë shërbime të menjëhershme, afatshkurtra dhe afatgjata, mbështetëse, të specializuara për çdo viktimë dhe fëmijët e tyre.

Aktualisht në Shqipëri, shërbimet e ofruara për viktimat e dhunës në familje janë të ndara në dy lloje: të përgjithshme dhe të specializuara.

Sipas Raportit GREVIO (2017)⁷ në nivel kombëtar, 42 shërbime (69.3%) janë shërbime të përgjithshme dhe 19 (30.6%) janë shërbime të specializuara. Nga këto 12 ofrues të shërbimeve (20.3%) punojnë me viktimat e dhunës drejtpërdrejtë rreth 75% ose më shumë, 10 ofrues të shërbimeve (16.9%) punojnë direkt në rreth 50-75% të punës së tyre, 11 ofrues të shërbimeve (18.6%) punojnë direkt në rreth 25-50% të punës së tyre, 12 ofrues të shërbimeve (20.3%) punojnë direkt në më pak se 25% të punës së tyre. Në mënyrë të veçantë në lidhje me shërbimet e specializuara, rezultatet tregojnë se shtatë ofrues të shërbimeve (53.8%) i dedikojnë 75% ose më shumë në punën e tyre viktimave të dhunës drejtpërdrejtë; dy shërbime (15.4%) ia dedikojnë drejtpërdrejtë 50-75% të punës së tyre; dy shërbime (15.4%) ia

⁶ Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, prill 2011, ratifikuar nga Shqipëria në 19 dhjetor 2011;

⁷ Raport i paraqitur nga Shqipëria sipas Nenit 68, paragrafi 1të Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Raporti Bazë) marrë nga GREVIO më 16 janar 2017;

dedikojnë 25-50% të punës së tyre drejtpërdrejtë dhe dy shërbime të tjera (15.4%) i kushtojnë drejtpërdrejtëmë pak se 25% të punës së tyre viktimave të dhunës.

Nëse do t'i gruponim ato në kategoritë kryesore, llojet e shërbimeve të ofruara nga shërbimet e përgjithshme dhe të specializuara janë si më poshtë: 11 prej tyre (7%) ofrojnë strehim, punësim dhe programe të formimit profesional; 14 (9%) linjë telefonike; 35 (24%) mbështetje për viktimat e dhunës seksuale; 28 (19%) mbështetje në procedurat ligjore; 20 (14%) ofrojnë shërbime në qendrën e këshillimit/emergjencës (krizës); 10 (7%) përfshijnë në shërbimet e tyre programe për autorët e dhunës dhe 29 (20%) përfshijnë në shërbimet e tyre mbështetje për fëmijët që janë dëshmitarë për dhunën.

Ka një numër të konsiderueshëm të OJF-ve në vend që punojnë për dhunën në familje. Ato ofrojnë mbështetje, shërbime dhe këshillime për viktimat e DHF; realizojnë fushata të informimit publik dhe rritjes së ndërgjegjësimit; si dhe ofrojnë trajnime për palët e përfshira në Reagimin e Koordinuar të Komunitetit (RKK). Rrjeti i shërbimeve përbëhet nga: a) Qendra me mision sensibilizimin e opinionit të gjerë, në mënyrë të veçantë të grave dhe vajzave, të fëmijëve dhe të rinjve si dhe të profesionistëve të fushave të ndryshme për probleme të dhunës gjinore; b) Qendra që ofrojnë mbështetje psikosociale; c) Qendra që ofrojnë këshillime juridike; ç) Qendra që ofrojnë strehim të përkohshëm dhe trajtim të specializuar për gra dhe vajza në situata krize që rrezikojnë edhe jetën e tyre; d) Qendra që ofrojnë trajtim të specializuar për fëmijët; e) Programe të cilat ndihmojnë në trajnimin profesional dhe punësimin e grave në nevojë.

Aktualisht, të gjitha këto shërbime ofrohen kryesisht nëpërmjet projekteve të mbështetura nga donatorë të huaj. Si rezultat i mbështetjes së kufizuar financiare të shërbimeve sociale për viktimat e dhunës në familje nga ana e strukturave shtetërore, dhe disa herë e mungesës së fondeve nga donatorët e huaj, këto shërbime në shumë raste nuk janë aspak të qëndrueshme, duke bërë që disa herë viktimat e dhunës në familje të mos kenë se ku të drejtohen për ndihmë.

Konventa kërkon që viktimat e dhunës të kenë strehëzat e duhura lehtësisht të arritshme, në numër të mjaftueshëm, të cilat duhet të ofrojnë strehë të sigurt për viktimat dhe fëmijët e tyre.

Përveç Strehëzës Kombëtare, aktualisht në Shqipëri ekzistojnë 7 strehëza të tjera që ofrojnë shërbime për viktimat e DHF dhe ato të Trafikimit Njerëzor, ku pjesa më e madhe e tyre menaxhohen nga organizatat jo-fitimprurëse.

Studimi i kohëve të fundit për “Hartëzimin e Shërbimeve Mbështetëse për Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave”⁸ nxjerr përfundimin që “duhet të krijohen shërbime shtesë dhe të shtrihen në të gjithë vendin. Minimalisht duhet të plotësohen nevojat urgjente dhe të menjëhershme të grave dhe vajzave përmes linjave telefonike 24-orëshe falas, ndërhyrjeve të menjëhershme për sigurinë dhe mbrojtjen e tyre, akomodimit dhe strehimit të sigurtë për to dhe fëmijët e tyre, mbështetjes me shërbime këshillimi dhe psiko-sociale, përkujdesit pas-përdhunimit, dhe ndihmës juridike falas për t’i ndihmuar të kuptojnë të drejtat dhe zgjedhjet që mund të bëjnë”.

Pavarësisht nga përparimi i dukshëm që është bërë, duhen bërë më shumë përpjekje për të përmbushur kërkesat e konventave ndërkombëtare të ratifikuara, pra të KEGJFDG dhe Konventës së Stambollit. Me pikësynimin përfundimtar për mbrojtjen e grave nga dhuna, Konventa e Stambollit parashikon udhëzues dhe standarde për një sërë shërbimesh mbështetëse me qëllim fuqizimin e viktimavegra dhe aftësimin e tyre për t’u ri-integruar dhe për të mos u ri-viktimizuar.

⁸Kelly, L., J. Lovett, dhe M. Kocaqi (2015). “Albania Final Report: Mapping Violence against Women and Girls Support Services,” (Raporti përfundimtar për Shqipërinë: Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse për dhunën ndaj grave dhe vajzave) Këshilli i Evropës dhe UN Women.

Duhet të sigurohet riintegrimi i grave dhe vajzave mbijetuese të dhunës në familje përmes ofrimit të banesave sociale, punësimit, trajnimeve profesionale dhe aksesit në shërbime sociale. Përveç kësaj, duke qenë se mundësitë e pabarabarta ekonomike dhe të punësimit janë faktorë kyç që i bëjnë gratë dhe vajzat të mbeten në kurthin e situatave të dhunës, shfrytëzimit dhe abuzimit, reagimet ndaj DHF duhet të mbështeten me masa shumë më efektive dhe gjithëpërfshirëse që sigurojnë pavarësinë dhe fuqizimin ekonomik të grave, si përmes rritjes së punësimit, sipërmarrjes dhe trajnimit profesional. Përveç kësaj, nevojitet mbështetje e vazhdueshme në nivel kombëtar për të siguruar të drejtat de facto të grave për të zotëruar dhe trashëguar tokë dhe prona, pagë të barabartë për punë të barabartë dhe mjedis të sigurtë e të denjë pune.

Pavarësisht ndryshimeve dhe ndërhyrjeve të nevojshme nga të dhënat e studimeve rezulton se shkalla e raportimit të rasteve të dhunës kundër grave është ende e ulët, për shkak të aksesit të kufizuar të grave në shërbimet që lidhen me ndihmën juridike, si dhe mungesa e shërbimit telefonik për gratë viktime të dhunës, sidomos në zonat rurale dhe ato të thella.

Historikisht marrëdhëniet e pushtetit mes burrave dhe grave janë manifestuar nga pabarazi të theksuara, dominante dhe diskriminuese mes tyre, duke sjellë triumf në patriarkalizëm e dominim nga njëra anë në favor të burrave dhe shtypje e nënshtrim shekullor të grave nga ana tjetër. Kjo gjë ka bërë që gratë të pengohen dhe të ndeshin vështirësi të mëdha në mbijetesën, zhvillimin dhe emancipimin e tyre. Ky dominim është farkëtuar fort përmes shumë formave e trajtave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore, duke u legjitimuar edhe brenda familjes dhe duke e vendosur gruan në pozita varësie dhe inferioriteti. Ky fenomen i ka vendosur gratë dhe vajzat në situata kërcënuese për jetën e tyre dhe të fëmijëve përmes formave serioze të dhunës, si dhuna me bazë gjinore, dhuna në familje, ngacmimi seksual, përdhunimi, martesë e hershme, martesë e detyruar, krimet e kryera në emër të të ashtuquajturit “nder”, që përbëjnë shkelje të rëndë të të drejtave të grave dhe vajzave si dhe pengesë kryesore për arritjen e barazisë midis burrave dhe grave;

Prania e dhunës lë pasojë të mëdha në mirëqenien dhe integritetin fizik, psikologjik, ekonomik dhe social të shoqërisë në tërësi dhe në veçanti të grave, fëmijëve dhe të moshuarve.

Faktorët të cilët shkaktojnë dhunën në familje janë të ndryshëm, të tillë si: mentaliteti i vjetër dhe patriarkal, traditat e hershme patriarkale të dominimit mashkullor, kushtet ekonomike, varfëria, stereotipet, papunësia, diskriminimi gjinor, marrëdhëniet mes brezave në familje, mjedis jo i favorshëm familjar, si dhe shumë faktorë të tjerë, të cilët kanë ndikuar në përhapjen e këtij fenomeni në përmasa të frikshme.

Konventa e KE-së është instrumenti i parë në Evropë, që përbën detyrim ligjor, dhe traktati më i gjerë ndërkombëtar që krijon një kuadër ligjor gjithëpërfshirës për trajtimin e kësaj shkeljeje të rëndë të të drejtave të njeriut. Ajo e përkufizon termin “dhunë në familje” si të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike, që ndodhin brenda familjes ose në njësi shtëpiake, ose ndërmjet ish-bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.

Sipas Ligjit të Dhunës në Familje (i ndryshuar)⁹ termi “dhunë në familje” është çdo akt dhune, i përcaktuar sipas pikës 1¹⁰, të këtij neni, që ndodh brenda familjes ose në njësi shtëpiake, e ushtruar

⁹ Ligji nr.9669 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare (i ndryshuar nr. 125/2020)

ndërmjet pjesëtarëve të familjes, të përcaktuar në pikën 7, të këtij neni, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.

Sipas të dhënave të UN Women¹¹ aktualisht sot në botë raportohet se:

- Gratë që janë abuzuar fizikisht ose seksualisht nga partnerët e tyre kanë më shumë se dyfishin e probabilitetit të abortit, pothuajse dy herë më shumë gjasa për depresion dhe në disa rajone 1.5 herë më shumë gjasa për të marrë HIV/AIDS, krahasuar me gratë që nuk përjetojnë dhunë nga partneri;
- Megjithëse ka pak të dhëna të disponueshme - dhe ndryshime të mëdha në mënyrën se si ndihet dhuna psikologjike midis vendeve dhe kulturave - dëshmitë ekzistuese tregojnë norma të larta prevalenciale. 43% e grave në 28 shtetet anëtare të BE-së kanë përjetuar një formë të dhunës psikologjike nga një partner intim gjatë jetës së tyre.

Shërbimet sociale janë një faktorë i rëndësishëm i mbështetjes së viktimave të dhunës në familje. Sipas Grevio (2017), 10 ofrues të shërbimeve (12.9%) ofrojnë strehim, nga të cilat një është krijuar posaçërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara, dhe një për personat LGBTI. Këto strehëza ekzistuese ofrojnë gjithsej 153 shtretër për gratë dhe fëmijët e tyre viktimë të dhunës dhe numri i personave që mund të strehohen në secilën prej tyre në të njëjtën kohë varion nga 5 në 50. Për të arritur standardin minimal të kërkuar nga Konventa e Stambollit (1 shtrat për 10,000 banorë) Shqipëria do të duhet të sigurojë një shtesë prej 137 shtretër.

II. METODOLOGJIA PËR HARTIMIN E STRATEGJISË

2.1 Metodologjia për mbledhjen e të dhënave

Shoqata ka filluar punën për rishikimin e Strategjisë së re 5-vjeçare për periudhën 2023-2027. Nëpërmjet takimeve të shumta me anëtarët e shoqatës, me punonjës të administratës në nivel qendror dhe vendor, me gra të zgjedhura në nivele politike vendimmarrëse dhe me përfituese të projekteve të ndihmës për gratë, Shoqata ka mundur të reflektojë për një sërë aktivitete të kryera gjer më tani dhe për ato që do të kryhen në të ardhmen dhe që duhen parashikuar në Strategjinë e re. Në plotësim të misionit të shoqatës, të gjitha inputet e vlefshme të personave dhe grupeve të përfshira në hartimin e kësaj Strategjie të re, janë strukturuar në formë objektivash dhe veprimtarish. Për mbledhjen e sa më shumë opinioneve të vlefshme për hartimin e strategjisë, shoqata ka përdorur në mënyrë thuajse shteruese disa metoda kërkimore siç janë: workshop, intervista, fokus-grupet, bisedat e lira dhe analizën e teksteve të politikës gjinore dhe dokumenteve ligjore e zyrtarë të shkruara në fushën e çështjeve gjinore në Shqipëri. Më poshtë jepet një përmbledhje e të dhënave të mbledhura përmes instrumenteve kërkimore të përdorura për hartimin e kësaj strategjie.

2.1.1 Analiza e dokumentacionit

Analiza e dokumentacionit u përdor për të analizuar tekstet zyrtare, për të kuptuar përmbajtjen dhe qëllimin e politikave publike në lidhje me barazinë gjinore. Analiza e teksteve zyrtare ka rëndësi të veçantë për të përsëritur studimin në intervale të caktuara kohore, për të treguar rrugëtimin e strategjisë

¹⁰ Pika 1. “Dhunë” është çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.

¹¹<http://www.unwomen.org/en/what-we-do/ending-violence-against-women/facts-and-figures>

përgjatë zbatimit të saj. Tekstet e analizuara në këtë kërkim janë dokumentet ligjore dhe politike të prodhuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ajo janë kryesisht:

- Deklarata Universale e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (DUDNJ), miratuar në 10 dhjetor 1948 dhe protokollet e saj, e cila shpalli konceptin e barazisë ndërmjet qënieve në të gjithë botën.
- Konventa Ndërkombëtare e OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, miratuar në 1966 dhe ratifikuar më 4 tetor 1991.
- Konventa e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave¹² (KEGJFDG) miratuar në 1979, ratifikuar më 11 maj 1994 dhe Protokollin e saj Opsional (1999). Kjo Konventë është konsideruar si "një projekt-ligj ndërkombëtar i të drejtave për gratë". Ajo e përcakton diskriminimin në një mënyrë shumë thelbësore, duke e bërë të qartë se gratë kanë të drejtën e gëzimit të plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave të tyre njerëzore.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF) miratuar në 1989 dhe Protokollet e saj Opsionale (2000), u ratifikua më 27 shkurt 1992. Kjo konventë siguron autorizim të qartë për shtetin për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e dhunës në në familje, si dhe përcakton rolin e saj si arbitër përfundimtar i mirëqenies së fëmijëve brenda vendit.
- Konventa e OKB-së kundër Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar, ratifikuar më 11 Maj 1994.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2006), u ratifikua në dhjetor 2012;
- Karta Sociale Europiane (ETS Nr. 35, 1961, erishikuar në 1996, ETS Nr.163),
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollin e saj, ratifikuar më 10 shkurt 1996.
- Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruar ratifikuar më 10 shkurt 1996.
- Konventa e Këshillit të Europës mbi Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual (CETS Nr. 201, 2007);
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje (e njohur si Konventa e Stambollit) në prill të vitit 2011. Kjo Konventë u ratifikua më 19 dhjetor 2011.
- Rekomandimi i Përgjithshëm Nr 19 të Komitetit CEDAË mbi dhunën kundër grave;
- Rekomandimet e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare të Këshillit të Europës: Rekomandimi (2002) mbi mbrojtjen e grave nga dhuna;
- Rekomandimi (2007) mbi standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore;
- Rekomandimi (2010) mbi rolin e burrave dhe grave në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve dhe vendosjen e paqes, dhe rekomandime të tjera përkatëse;

¹² Njohur ndryshe si CEDAW

- Rekomandimet e Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave (CEDAË), të miratuara në vitin 2016 dhe rekomandimet në raportin e parë të vlerësimit mbi Shqipërinë, të Grupit të Ekspertëve të Këshillit të Europës, “Mbi luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO)”, të publikuara më 24 nëntor 2017.
- Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Shtator të 2015. Kjo marrëveshje historike e ndërtuar mbi sukseset e Objektivave të Zhvillimit të Mijë-vjeçarit krijoi për herë të parë një kornizë veprimi universale për të zhdukur varfërinë dhe për të zvogëluar pabarazinë, duke promovuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, të bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut.

Kuadri ligjor kombëtar për dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje në Shqipëri;

- ✓ Kushtetutën e re të Republikës së Shqipërisë. (neni 18/2, neni 54/1, neni 54/3)
- ✓ Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë (neni 124/b, neni 130/a)
- ✓ Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë (neni 62)
- ✓ Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë (neni 9)
- ✓ Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"
- ✓ Ligji Nr. 9914, datë 12.5.2008 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006" Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare ", ka caktuar Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si një autoritet tjetër përgjegjës për dhunën në familje. Ligji është ndryshuar më 30.09.2010 me Ligjin nr. 10 329.
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 07.02.2011 "*Për krijimin e një sistemi kombëtar referimi për viktimat e dhunës në familje dhe mënyrën e funksionimit të tij*".
- ✓ *Ligji Nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për Barazinë Gjinore në shoqëri"* rregullon aspektet kryesore të barazisë gjinore në të gjitha fushat për një trajtim të barabartë ndërmjet burrave dhe grave.
- ✓ *Ligji Nr. 10 221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi"*, i cili rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë i lidhur me një sërë arsyes joshteruese, duke përfshirë dhe gjininë.
- ✓ *Ligji Nr. 10.399, datë 17.03.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005" Për ndihmën dhe shërbimet sociale"*, sanksionet që gratë e dhunuara gjithashtu kanë të drejtë të përfitojnë pagesën e ndihmës ekonomike në rastet kur ato kanë UM/UMM,
- ✓ Ligj Nr. 125/2020 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006,“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.
- Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2021-2030,
- Udhëzime të Treguesve të Harmonizuar për Barazinë Gjinore dhe Statusin e Grave në Shqipëri.
- Strategjia Kombëtare për Decentralizim 2023 – 2027
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2020-2022
- Plani Vendor i Barazisë Gjinore 2023 – 2025, Bashkia Durrës

- Plani Lokal Social 2021 – 2024, Bashkia Durrës.

2.1.2 Workshop

Workshopi u realizua me mbështetjen e AWEN/ Sida. Në këtë workshop morën pjesë 12 përfaqësues, staf dhe anëtarë të tjerë të shoqatës. Disa nga çështjet në të cilat u fokusua gjatë takimi janë: Prioritetet dhe masat e propozuara si pjesë e Strategjisë së re 2023 -2027, rishikimi i arritjeve të ShGPS në vitet e fundit, aspektet dhe fushat ku është angazhuar Shoqata dhe çfarë mund të përmirësohet, përfshirja e objektivave strategjike të Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri. Disa nga pikat konkrete gjatë të cilave u fokusua ky workshop, ishin: elementë të Rregullores së ShGPS, çështje të lidhura me rritjen e vizibilitetit dhe promovimin e aktiviteteve të shoqatës, analizimi i pikave të forta dhe të dobëta të punës së Shoqatës, si dhe planet e ardhshme me fokus ofrimin e shërbimeve dirkte, lobimin dhe advokimin, fuqizimin ekonomik dhe rritjen profesionale të stafit.

2.1.3 Fokus grupet

Fokus grupi, që bazohet në intervistën e grupit, lejon që pjesëmarrësit të analizohen në kontekstin e tyre duke shmangur kështu dekontekstualizimin. Fokus grupi përdori ndërveprimin si mënyrë për mbledhjen e të dhënave, pasi ndërveprimi ofron më shumë të dhëna për pikëpamjet e pjesëmarrësve në kërkim se sa intervista që dominohet prej kërkuesit më së shumti. Për më tepër, informacioni nga fokus grupi ishte i pasur sepse u sigurua prej shumë individëve. Fokus grupi i ndihmoi pjesëmarrësit të përcaktojnë vetë kuptimin e veprimeve të tyre. Karakteristika përcaktuese e të qenit pjesëtar i fokus grupit ishte angazhimi në veprimtaritë e shoqatës përgjatë pesë viteve të shkuara dhe përfitimi prej mbështetjes së ofruar nga shoqata. Në total u organizuan 5 fokus grupe të ndarë sipas kategorive, staf i SHGPS, bashkëpunëtorë (OJF të tjera, gratë përfaqësuese të partive politike, media), përfitues të drejtëpërdrejtë, koordinatorë lokalë, anëtarë të Bordit të shoqatës). Gjatë fokus grupeve u mblodhën të dhëna për opinionet e grave për zhvillimin e veprimtarive të shoqatës dhe për ndikimin e tyre në situatën e grave në nivel lokal.

Fokus grupet nxorën në pah një sërë problemesh lidhur me zbatimin e strategjisë së barazisë gjinore dhe situatën problematike të gruas në aspektin ekonomik, përfaqësimin politik dhe dhunën në familje. Edhe pse pranojnë që ka dokumente politike për avancimin e çështjes së gruas, përfitueset e projekteve dhe përfaqësueset e zgjedhura raportojnë se pak ndryshime janë prodhuar në realitet si pasojë kryesisht e rezistencës kulturore ndaj barazisë gjinore.

Përqindja e grave parlamentare gjithashtu u rrit nga 16% në 28.5% në parlamentin e ri. Numri i grave në parlamentin e kaluar kombëtar ishte 23, në legjislaturën aktuale ekzistojnë 39 gra të zgjedhura si anëtare e parlamentit kombëtar nga 140 anëtarët.

Aktualisht nga 141 anëtarë, janë vetëm 122 deputetë në Parlamentin shqiptar për shkak të situatës së fundit politike në Shqipëri. Aktualisht janë 36 gra, 29.5%. Janë 8 gra (13.1%) të zgjedhura si kryetare në zgjedhjet lokale të vitit 2019 nga 61 kryetarë në total. 44% e anëtarëve të Këshillit Bashkiak janë gra.

Sipas të dhënave të mbledhura, në zgjedhjet lokale të vitit 2011, gratë ishin vetëm 12.27 përqind e anëtarëve të këshillave lokale (754 këshilltarë nga 6144 në total). Nga 384 njësi e qeverisjes vendore

vetëm 91 ishin gra, d.m.th. rreth 23.7 përqind. Prania e grave në këshillat lokale ishte më e lartë në zonat urbane në krahasim me ato rurale: në 28.25 përqind të komunave asnjë grua nuk ishte anëtare ndërsa kjo situatë ishte në 6.15 përqind të bashkive.

Një tjetër arritje nga fokus-grupi cilësohet mbështetja e projekteve të vetpunësimit të grave kryesisht në zonat rurale dhe turistike. Kështu në qarkun e Korçës dhe të Pogradecit janë mbështetur disa iniciativa vetëpunësimi të grave në sektorin e hoteleri-kulinarisë dhe në punë artizanale si: qëndistari, bizhuteri, që promovojnë vlerat lokale të zonës dhe që tërheqin turistë. Gjithësesi, iniciativat e mbështetura nga shoqata janë të brishta dhe rrezikohen nga konkurrenca e tregut dhe nga produktet e gatshme të prodhuara në seri nga industria e ushqimit dhe veshjes.

Një tjetër aspekt pozitiv i punës së shoqatës është mbrojtja nga dhuna për gratë e dhunuara kryesisht të qarkut të Durrësit, të cilave shoqata u ofron ndihmë ligjore falas kundër dhunës në familje dhe kundër diskriminimit gjinor, mbështetur në Ligjin "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" nr. 9669, datë 18.12.2006 i ndryshuar Pavarësisht punës së pareshtur që shoqata bën në këtë drejtim, ajo është e pamjaftueshme, pasi kapaciteti për shërbim që posedon shoqata për momentin nuk mund të akomodojë kërkesat në rritje për ndihmë ligjore falas, sepse shërbimi është i kushtueshëm dhe nuk subvencionohet nga shteti. Kapaciteti ofruet për mbrojtje ligjore nga dhuna përbën një përparësi imediate për shoqatën për vitet e punës në vijim.

Megjithatë, vetëm mbrojtja ligjore nga dhuna e ofruar prej shoqatës nuk mund të adresojë probleme të dhunës gjithnjë e në rritje. Pjesëtarët e komunitetit, të familjeve dhe struktura të qeverisjes vendore dhe policisë së shtetit duhet të tregojnë më shumë angazhim përmes koordinimit komunitar për mbrojtjen nga dhuna. Fushatat ndërgjegjësuese për qytetarët dhe takimet lobuese me autoritetet vendore për t'u bërë të përgjegjshëm për ta luftuar dhunën janë një objektiv parësor. Edhe me shkollat duhet punuar, si me mësuesit edhe me nxënësit që ata të ndjejnë përgjegjësi për të luftuar dhunën në emër të vlerave qytetare. Ndërsa, përsa i përket punonjësve të administratës publike vendore dhe policisë së shtetit, mungesa e formimit në fushën e barazisë gjinore bën që prishmëritë profesionale të tyre për të luftuar dhunën me bazë gjinore të mos plotësohen. Deri më sot praktika e urdhërave të mbrojtjes të nxjerra nga bashkëpunimi i të dhunuarës me shoqatën, policinë e shtetit dhe gjykatën ka funksionuar relativisht në mënyrë të kënaqshme, pavarësisht problemeve të tejzgjatura të praktikave të mbrojtjes të cilat marrin shumë mund, energji dhe orë pune që variojnë nga 9-30 orë pune për rast (UN WOMEN, 2011). Mundësitë ligjore për të materializuar mbrojtjen në praktikë nuk janë zhvilluar plotësisht dhe ka raste që për shkak mosmonitorimi nga ana e policisë edhe ato urdhra që ekzistojnë të mos zbatohen fare. Zbatimi efektiv i urdhërave të mbrojtjes mundësohet vetëm nga monitorimi elektronik përmes vënies së byzylykut sinjalizues në dorën e agresorit dhe aparatit sinjalizues në trupin e viktimës, që të njoftohet njëkohësisht edhe gruaja edhe punonjësi i policisë për praninë e agresorit në zonën e viktimës. Në Shqipëri kjo praktikë e monitorimit me byzylyk, ka filluar të zbatohet që prej vitit 2013 nga shërbimi i provës për të dënuarit me burg për vepra penale të lehta, për të cilat jepet dënim deri në 5 vjet heqje lirie, por jo për rastet e ushtrimit të dhunës në familje. Por do ishte një praktikë shumë e mirë për monitorimin e rrezikut të pranisë së dhunës në familje të ushtruar nga persona që janë vënë nën vëzhgim prej urdhrit të mbrojtjes.

- Bashkia Durrës ka hasur problematika në trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe shërbimeve specifike për të adresuar nevojat e kësaj kategorie.
- **Sfidë për këtë bashki mbetet edhe raportimi i dhunës në zonat rurale**, pasi shumë raste dhune në zonat rurale nuk raportohen.
- Një tjetër vështirësi që haset për këtë kategori, është ajo e trajtimit afatgjatë të viktimave të dhunës përmes ofrimit të shërbimeve mbështetëse të rehabilitimit.
- **Trajtimi i dhunuesve është një tjetër problematikë e rëndësishme që Bashkia e Durrësit ka hasur edhe përgjatë vitit 2022.**

2.1.4 Intervistat

Intervistat u zhvilluan në formë bisede për të marrë më shumë informacion nga të intervistuarat. Qëllimi ishte të merrej sa më shumë informacion pa ndërhyrë në rrjedhën e bisedës. Në këtë studim intervistat u zhvilluan në formën e diskutimit të bazuar në një listë pyetjesh që kishin për qëllim të merrnin informacion për gjendjen e grave. Intervista mbuloi çështje të lidhura me 3 fusha: gjendjen ekonomike, përfaqësimin politik dhe dhunën në familje dhe siguria e grave. U zhvilluan intervista me anëtare të shoqatës, themeluese të shoqatës, vullnetare, stafi aktual dhe ai në të kaluarën, bashkëpunëtorë ndër vite si gra përfaqësuese të partive politike, përfaqësues të OJF-ve të tjera që operojnë në qarkun e Durrësit dhe jo vetëm, partnerë, përfaqësues të institucioneve vendore, përfitues etj.

2.1.5 Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave u krye përmes kodimit dhe kategorizimit të të dhënave. Kodimi shërbeu për të lehtësuar interpretimin e opinioneve të mbledhura dhe të teksteve të shqyrtuara. Të dhënat nga fokus grupet dhe intervistat u transkriptuan. Në fillim u krijuan kodet për njësitë kuptimore, dhe njësitë u klasifikuan dhe u strukturuan nëpër narrativa përshkruese. Së fundmi, të dhënat u interpretuan për t'i dhënë shpjegim opinioneve të mbledhura. Të dhënat e mbledhura nga tekstet, intervistat dhe fokus grupet u trianguluan për të plotësuar interpretimin.

Intervistat dhanë informacion të pasur për çështjet që lidhen me gjendjen e grave në fushat: aktivizim ekonomik, përfaqësim politik dhe dhunën në familje. Të intervistuarit u shprehen se ndërhyrjet e shoqatës kanë sjellë efekte pozitive për gjendjen e grave dhe se shoqata duhet të mbështetet për të vazhduar projektet e nisura dhe për të përmbushur misionin. Megjithatë, përsa i përket procesit të mbajtjes së rezultateve të projekteve të shoqatës, të intervistuarit ndajnë opinione të ndryshme, ndonjëherë edhe kontradiktore.

Kështu, përfaqësuesit e qeverisjes vendore në nivel kryetarësh shprehen se shoqata duhet të ngrejë fonde jashtë buxhetit të bashkisë për ofrimin e shërbimeve ndaj të tretëve sepse kjo mënyrë mund të sigurojë më shumë të ardhura dhe qëndrueshmëri financimi krahasuar me financimin prej fondeve të bashkisë/komunës të cilat jo vetëm që nuk janë të sigurta por edhe mund të paraqesin probleme në shpërndarje apo paspagim si pasojë e procedurave burokratike. Për më tepër, probleme mund të shfaqen edhe në procesin e përzgjedhjes së aplikantëve garues për fonde publike, si pasojë e ndërhyrjeve politike dhe presioneve korruptive. Prandaj, financimi i shërbimeve mbështetëse për gratë

nga burime jo-shtetërore, pra nga organizma ndërkombëtare, është mënyrë më e sigurtë dhe më e qëndrueshme për përfaqësuesit e qeverisjes vendore. Mosdikimi nga ndërhyrjet politike dhe presionet korruptive ka efekte pozitive në procesin e përzgjedhjes dhe mundëson financimin e projektit më të mirë.

Ndërsa për anëtarët e shoqatës, dhe për përfitueset e projektit, si dhe për tre (3) përfaqësuese të partive politike, përzgjedhja e projekteve fituese duhet të bëhet në bazë të procedurave ligjore të tenderimit për OJF të linçencuara në fushën e shërbimeve mbështetëse për gratë, të cilat edhe duhet të diversifikohen në tipologji se janë shumë të kufizuara për momentin dhe përfaqësohen vetëm nga shërbimet sociale të ofruara në qendra ditore ose rezidenciale. Monopolizimi i shumë shërbimeve nga një shoqatë e vetme, siç edhe ka ndodhur, ka treguar se përqëndrimi i shumë përgjegjësive ofruese në duart e një organizate të vetme ka prodhuar efekte negative për shërbimin dhe për përfituesit sepse janë pakësuar alternativat e shërbimit dhe shërbimi mund të jetë ndërprerë ose nuk ka qenë cilësor. Ndërsa, një pakicë e të intervistuarave, 4 prej tyre (3 përfituese dhe një politikane) ndajnë opinione kontradiktore. Nga njëra anë ato e lëvdojnë procesin përzgjedhës nga organizma ndërkombëtare, sepse e mbron procesin nga presioni korruptues, por nga ana tjetër e kritikojnë sepse mendimi i donatorit mund të jetë jo shumë i informuar dhe i bazuar në kontekst dhe se përzgjedhja e donatorit mund të duket imponuese. Gjithashtu të gjithë janë kritikë ndaj procedurave burokratike të përzgjedhjes së projekteve për financim dhe ankohen për pamjaftueshmërinë financiare dhe paqëndrueshmërinë e rezultateve të projekteve.

III. STRATEGJIA E SHOQATËS

3.1 Historiku i shoqatës

Ndër veprimtaritë kryesore që shoqata ka përmbushur në zbatim të strategjisë gjatë periudhës 2020 - 2022 janë në fushën e përmirësimit të gjendjes ekonomike dhe luftës kundër varfërisë femërore, si dhe mbrojtje të viktimave të dhunës në familje, fuqizim ekonomik të të rinjve pjesë të grupeve vulnerabël, mbështetje të të prekurve nga tërmeti. Mbështetja e shoqatës mund të kategorizohet në ofrim informacioni për punësim, mbështetje përmes start up-eve strehim; shërbim psiko-social, mbrojtje ligjore falas për raste të dhunës në familje dhe ndihmë ushqimore dhe ekonomike për gratë në nevojë.

Nisur nga veprimtaritë e deri më tanishme të zbatuara në kuadër të strategjisë së mëparshme (2020-2022) dhe nga nevojat ekzistuese të evidentuara nga opinionet e personave që bashkëpunuan për hartimin e strategjisë, shoqata ka hartuar një strategji të re 5-vjeçare për periudhën 2023-2027, e cila mbështetet dhe është në vijim të zbatimit të vizionit dhe qëllimeve të shoqatës.

Përmes projekteve të ndryshme, SHGPS synon të ofrojë shërbime të drejtpërdrejta për viktimat e dhunës në familje, duke përfshirë: ofrimin e informacionit, shërbimin juridik dhe psikologjik; ngritjen e ndërgjegjësimit publik mbi fenomenin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore; dhe forcimin e aftësive të autoriteteve të qeverisjes vendore se si t'i përgjigjen në mënyrë efektive nevojave të viktimave të dhunës në familje, fuqizimin ekonomik të grave e vajzave pjesë e grupeve në nevojë.

Përfitues të drejtpërdrejtë janë gratë e marginalizuara dhe të rrezikuara duke përfshirë: viktimat e dhunës në familje, viktimat e dhunës me bazë gjinore, gratë e divorcuara, gratë që kalojnë në proceset gjyqësore të divorcit si rezultat i dhunës, gratë që jetojnë në zonat rurale, gratë që kanë vështirësi ekonomike, administratorët socialë dhe aktorët e tjerë lokalë të Mekanizmit të Referencës së Dhunës në Familje (DVRM), oficerët e policisë të Drejtorisë Rajonale të Policisë Durrës; stafi i zyrës së barazisë gjinore në Institucionin e Qarkut Durrës; dhe njësitë administrative të përfshira në projekt, siç janë: Manëz, Katundi i ri, Sukth, Rrashbull, Ishëm dhe Spitallë/ Porto - Romano.

3.2 Vizioni strategjik

Zhvillimi social-ekonomik kushtëzohet prej pjesëmarrjes së grave në prodhimin dhe rishpërndarjen e të mirave publike. Zbatimi i politikave të barazisë gjinore shërben si premisë për arritjen e barazisë gjinore në vendimmarrjen publike si dhe rrit aksesin e grave në politikë, tregun e punës, në përfitimin e shërbimeve publike të mbrojtjes shoqërore dhe në vendimmarrjen brenda familjes. Për ta realizuar barazinë gjinore është e domosdoshme të përcaktohen objektiva të qarta dhe të arritshme që lehtësojnë gëzimin e të drejtave bazë për gratë siç janë: e drejta për punësim, për jetë familjare të sigurtë dhe për pjesëmarrje qytetare dhe vetëpërfaqësim. Që gratë të gëzojnë të drejtat e ligjshme duhet punuar për fuqizimin e zërit të tyre në politika që prekin jetët e tyre, të familjeve të tyre dhe komuniteteve ku jetojnë e punojnë. Gjithashtu, për arritjen e këtij vizioni janë të nevojshme ndërhyrjet “*pro – gjinore*” që garantojnë ndryshime pozitive në jetën e grave.

Synimi kryesor i strategjisë është përfshirja e çështjeve gjinore në politikat publike nëpërmjet planeve konkrete të veprimit, të detajuara dhe buxhetuara për të hedhur bazat për avancimin e barazisë gjinore dhe minimizimin e fenomenit të dhunës në familje në të ardhmen, mbështetur në dokumentat, rekomandimet dhe instrumentat ndërkombëtare, duke iu referuar kushteve konkrete të Shqipërisë.

Zbatimi i axhendës “Gruaja, Paqja, Siguria” dhe Rezolutës 1325 në vendin tonë shihet në kuadër të kësaj strategjie si një prej terrreneve e cila përforcon arritjen e barazisë dhe përfshirjes gjinore në vendin tonë.

3.3 Qëllimet strategjike

Prioritetet strategjike në bazë të fushave përkatëse shprehen në qëllimet e mëposhtme:

1. Fuqizimi politik i gruas nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së saj në vendimmarrje;
2. Fuqizimi ekonomik i gruas dhe rritja e mundësive të saj për punësim/vetpunësim dhe kualifikim profesional;
3. Përmirësimi i situatës sociale të grave në risk nëpërmjet rritjes së qasjes së tyre ndaj shërbimeve sociale cilësore.
4. Rritja e ndërgjegjësimit ndaj dukurisë së dhunës, mbrojtje ligjore dhe administrative si dhe mbështetje për individë të prekur nga dhuna në familje dhe dhunuesit.
5. Forcimi i zbatimit të axhendës kombëtare Gruaja Siguria dhe Paqja, duke u fokusuar në zbatimin e duhur të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Planit Kombëtar të Veprimit përkatës të qeverisë shqiptare përmes monitorimit dhe avokimit dhe lobimit për zbatimin e tyre dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për çështjet e WSP. "

Rritja e pjesëmarrjes së grave në strukturat vendimmarrëse dhe jetën politike është tashmë e njohur dhe e pranuar si mjet për fuqizimin e grave. *Së pari*, është provuar se vendet në të cilat gratë kanë një pjesëmarrje në jetën politike më të ulët se 30 përqind, kanë më shumë pabarazi e janë më pak përfshirëse dhe demokratike. *Së dyti*, është i njohur fakti se gratë përfaqësojnë interesa të ndryshme nga burrat. Pjesëmarrja direkte e tyre në strukturat vendimmarrëse ndikon në prioritarizimin e çështjeve që nuk janë të specifikuar nga burrat. *Së fundi*, pjesëmarrja e grave në jetën politike dhe vendimmarrje përmirëson ndjeshëm nivelin e qeverisjes. Fuqizimi i grave arrihet nëpërmjet fuqizimit ekonomik dhe rritjes së mundësive për punësim dhe kualifikim profesional. Fuqizim ekonomik do të thotë që gruaja të marrë pjesë ose të influencojë vendime, të ketë peshë në zhvillimin ekonomik të një vendi, të ketë mundësi të barabarta për të treguar aftësitë e saj menaxhuese jo vetëm në familje, por edhe në biznes, të luajë rol të ndjeshëm në krijimin e të ardhurave për familjen dhe për vendin, duke u bërë kështu ekonomikisht e pavarur. Po kaq të rëndësishme dhe të domosdoshme janë dhe veprimet e tjera që duhet të ndërmerren kryesisht në fushat e kujdesit social me qëllim arritjen e barazisë gjinore në shoqëri. Dhuna në familje si një shprehje e pabarazisë gjinore i bën femrat veçanërisht të prekshme ndaj vulnerabiliteteve të ndryshme si mospasja e aksesit të shërbimeve, papunësia, dobësimi ekonomik. Këto nga ana e tyre nxisin dhunën. Ndaj është e domosdoshme që të krijohet një aktivitet i qëndrueshëm dhe pozitiv ku përfshihen dhënie shërbimesh që janë efektive, të arritshme dhe të barabarta, si dhe mbrojtje dhe mbështetje e përmirësuar për të gjithë viktimat dhe parandalim efektiv i dhunës në familje.

3.4 Objektivat strategjike

Për arritjen e qëllimeve të strategjisë përcaktohen objektivat e mëposhtme:

- *Rritja e përfaqësimit politik*

Objektivat:

- Rritja e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrjen publike përmes përfaqësimit të drejtëpërdrejtë politik
- Ndërgjegjësimi shoqëror për dobinë e përfaqësimit politik të grave

- *Fuqizimi ekonomik*

Objektivat:

- Formimi profesional për gratë e papuna
- Mbështetja e sipërmarrjes private të grave në nevojë
- Krijimi i inkubatorëve artizanale dhe promovimi i produkteve artizanale të prodhuara nga gratë

- *Mbrojtja sociale*

Objektivat:

- Mbulimi me shërbim social mbrojtës për gratë në nevojë në nivel bashkie
- Zgjerimi i shërbimit komunitar në nivel qarku
- Lobimi në nivel qarku/bashkie/komune dhe këshilli vendor për financimin e shërbimeve sociale të përshtatshme për grupet në nevojë

- *Lufta kundër dhunës në familje*

Objektivat:

- Mbrojtje për viktimat e dhunës familjare përmes ofrimit të shërbimeve direkte dhe mbështetëse
- Ofrim shërbimi komunitar për parandalim/ndërhyrje në rast dhune familjare
- Funksionimi i sistemit të referimit për mbrojtjen nga dhuna

- *Zbatimi i axhendës kombëtare “ Gruaja, Paqja dhe Siguria*

Objektivat:

- Monitorimi i axhendës kombëtare Gruaja, Paqja Siguria dhe informimi i shoqërisë mbi rezultatet e monitorimit;
- Zbatimi i duhur i Rezolutës 1325/Planit Kombëtar të Veprimit t nga institucionet përgjegjëse;
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut mbi axhendën Gruaja Paqja e Siguria

IV. NDËRHJRJET

4.1 Veprimtaritë

Në mënyrë që të përmbushen objektivat strategjike janë planifikuar të ndërmerren veprimtaritë e mëposhtme.

Për arritjen e qëllimit strategjik të *rritjes së përfaqësimit politik të grave në nivel kombëtar dhe lokal* do punohet për përmbushjen e dy objektivave, që kanë të bëjnë me mbështetjen e grave politike për kandidim politik në lista dhe garim në parti. Këto objektiva do plotësohen përmes këtyre veprimtarive:

Për rritjen e përfaqësimit politik

- Mbështetja e grave politike në zgjedhjet brenda partisë dhe kandidim në lista
- Trajnim i partive politike për barazinë gjinore në përfaqësimin politik
- Lobim ndërmjet forumeve të grave për arritjen e balancës gjinore në përfaqësimin politik dhe në strukturat drejtuese partiake

Për ndërgjegjësimin shoqëror për barazi gjinore në përfaqësimin politik

- Fushatë ndërgjegjëse për mbështetjen e grave në zgjedhje dhe emërimet në strukturat e pushtetit ekzekutiv
- Kontribut në hartimin e politikave pro-gjinore në nivel vendor për barazi në vendimmarrjen lokale

Për fuqizimin ekonomik

Për fuqizimin ekonomik të grave në nevojë përmes punësimit dhe vetëpunësimit, do të punohet për përmbushjen e dy objektivave strategjike që kanë të bëjnë me formimin profesional dhe mbështetjen e start – ups si dhe sipërmarrjes private. Veprimtaritë për plotësimin e këtyre objektivave janë studime, shërbime këshillimore dhe mbështetje financiare për biznesin social, krijimi i inkubatorëve artizanale.

Për formimin profesional

Veprimtaritë:

- Studim i tregut të punës dhe nevojave për krahë pune
- Shërbim këshillimi për gratë punëkërkuese në nevojë
- Kontribut për nxitjen e politikave të punësimit në nivel vendor në sektorin publik dhe privat

- Lobim ndaj Bashkisë për subvencionim pjesor të pagës për gratë në nevojë, që janë përfituese të ndihmës ekonomike, por që janë edhe të punësuar në projektet e bashkisë për punë në dobi të komunitetit.
- Mbështetjen e grave dhe të rinjve në ndjekjen e kurseve profesionale dhe start ups sipas nevojave të identifikuar.

Për sipërmarrjen private në biznes të vogël

Veprimtaritë:

- Informim ligjor për kreditim biznesi për gratë aplikante
- Ndihmë për përgatitje plan-biznesi për gratë sipërmarrëse në bashkëpunim me institucionet e huasë dhe mikrokredive
- Program grantimi për biznes social
- Krijimin e inkubatorve artizanal

Për shërbim social

Për shërbim social komunitar në favor të grave në nevojë, parashikohen dy objektiva strategjike që kanë të bëjnë me aksesin në shërbimet sociale në nivel bashkie dhe zgjerimin e shërbimeve sociale në nivel qarku. Për arritjen e këtyre objektivave do të ndërmerren veprimtari mbështetëse për gratë në nevojë dhe familjet e tyre.

Për shërbim social komunitar në bashki

- Mbështetje të grave në nevojë me shërbime në familje, këshillim psiko-social dhe ligjor
- Trajnim i stafit të njësisë të qeverisjes vendore për shërbimet specifike për gratë

Për zgjerim shërbimi në nivel qarku

- Shtirje shërbimi ditor si: mbështetje në familje, këshillim psiko-social, këshillim ligjor, në komuna/fshatra përmes lobimit në qark
- Informim i grave dhe punonjësve të komunave për të drejtën për shërbim social

Për dhunën me bazë gjinore dhe në familje

Për luftën kundër dhunës në familje është parashikuar të punohet në drejtim të mbrojtjes së viktimave të dhunës familjare dhe në drejtim të parandalimit të dhunës brenda familjes. Këto objektiva do përmbushen në sajë të veprimtarive infomuese, sensibilizuese dhe edukuese për efektet negative të dhunës familjare si dhe përmes trajnimit të punonjësve vendore dhe mobilizimit të ekipeve vullnetare për parandalimin e dhunës në familje dhe për funksione ndërmjetësimi/pajtimi mes palëve në konflikt. Gjithashtu për trajtimin e dhunës familjare si për viktimat ashtu edhe për agresorët parashikohet të fuqizohet ekipi multidisiplinar komunitar, për të trajtuar rastet e dhunës në familje përmes denoncimit dhe referimit, si dhe të hartojë një plan masash për parandalim të dhunës në familje.

Për parandalimin e dhunës

- Informim dhe komunikim me publikun
- Studim vlerësues për përhapjen e dhunës në familje
- Veprimtari edukuese për të luftuar stereotipet gjinore dhe dhunën në familje
- Trajnim i stafit vendor për dhunën kundër grave

- Mobilizim dhe trajnim vullnetarësh për të punuar me familjen

Për ngritjen e shërbimit komunitar kundër dhunës në familje

- Ngritja e ekipit multi-disiplinar për viktimat e dhunës dhe agresorët
- Përgatitja e profilit të punës dhe detyrave të ekipit multidisiplinar

Për denoncimin dhe luftën kundër dhunës familjare në komunitet

- Vënia në funksion të pandërprerë e linjës telefonike falas për denoncimin e dhunës në komunitet
- Marrëveshje mirëkuptimi mes aktorëve komunitarë: shoqëri civile, polici, bashki
- Kontribut për hartimin e një plani masash në nivel vendor për mbrojtjen e familjeve nga dhuna brenda tyre

Për zbatimin e Rezolutës 1325 dhe PKV

- Avokimi për zbatimin e Rezolutës 1325 dhe PKV në nivel qendror dhe lokal
- Avokim për përfshirjen e balancës gjinore në aktivitetet e sektorit të sigurisë dhe përfshirjen e grave në vendim-marrje
- Avokim për integrimin e perspektivës gjinore në programet e edukimit për zbatimin e Rezolutës 1325
- *Për një ndërgjegjësim të rritur të publikut për Rezolutën 1325/Planin Kombëtar të Veprimit* Fushata ndërgjegjësuese për njohjen e Rezolutës 1325/Planit Kombëtar të Veprimit dhe rëndësinë e tyre në nivel lokal;
- Angazhimi i të rinjve, grave aktiviste, përfaqësuesve të pushtetit vendor në aktivitetet e ndërgjegjësimin.
- Vendosja e Pikave Informative në Njësitë e Qeverisjes Vendore.
- Lehtësimi i bashkëpunimit ndër-sektorial / ndër-institucional në nivel vendor dhe qendror.

4.2 Bashkëpunimi me partnerët

Për zbatimin e strategjisë pesë-vjeçare, shoqata do të bashkëpunojë me një sërë aktorësh që janë të përfshirë në çështjet gjinore dhe që ngarkohen me detyra për zbatimin e kuadrit ligjor dhe strategjik të barazisë gjinore dhe të mbrojtjes nga dhuna dhe diskriminimi. Ndër partnerët kryesorë me të cilët shoqata synon të bashkëpunojë në pesë vitet në vazhdim, 2023-2027, janë: organet e qeverisjes vendore, media, institucionet e shërbimit publik dhe organizata të shoqërisë civile që punojnë në komunitet.

Ndër veprimtaritë kryesore që shoqata do të ndërmarrë në bashkëpunim me qeverisjen vendore për zbatimin e strategjisë kombëtare të barazisë gjinore janë trajnimet e administratës vendore për çështje gjinore dhe fuqizimi i pikave fokale në të gjitha nivelet e qeverisjes vendore: qark/bashki/komunë. Një vëmendje e veçantë i kushtohet bashkëpunimit me të zgjedhurit vendore si këshilltarë bashkiakë dhe qarku që të kërkojnë buxhetim gjinor të fondeve publike të bashkive dhe komunave. Për këtë qëllim, shoqata do të hartojë edhe marrëveshje bashkëpunimi pesë-vjeçar me qarkun Durrës.

Media është partner strategjik i shoqatës në vijimësi për të adresuar çështje të dhunës në familje dhe të stereotipeve gjinore që dëmtojnë përparimin e vajzave dhe grave në jetën publike dhe vendimmarrjen

personale. Me median do të punohet për të ndryshuar portretizimin negativ që i gjykon gratë si subjekte të varura dhe të paafta për të marre vendime, si dhe të punojnë për të promovuar një imazh më aktiv dhe më të dobishëm shoqërisht të grave. Gjithashtu, me mediat do të punohet për të ngritur fonde për financimin e projekteve të shoqatës. Për këtë qëllim, shoqata do të angazhojë në punë me kohë të pjesshme një person që do të mbulojë sektorin e Marrëdhënieve me Publikun dhe Mediat.

Bashkëpunimi i shoqatës me rrjetet e shoqërisë civile si AWEN, Koalicioni që punon në fushën e çështjeve gjinore është objektiv madhor strategjik. Për këtë qëllim, shoqata do të vazhdojë bashkëpunimin e ngritur me organizata simotra dhe do të ndër marrë projekte të reja në partneritet me to për të ndarë ngarkesën e punës mbështetëse në komunitet si dhe për të përmbushur objektivat në lidhje me fuqizimin politik dhe ekonomik. Gjithashtu, me organizatat simotra do të punohet për ngritjen e një sistemi referimi shërbimesh komunitare për vajzat dhe gratë në mënyrë që ato të kenë mundësi të ndihmohen në komunitet, për vete dhe për familjet. Po ashtu, me shoqatat do të llobohet për rritjen e kapacitetit të përkujdesit shoqëror për fëmijët dhe të moshuarit në komunitet, në mënyrë që barra e përkujdesjes për familjarët të mos rëndojë vetëm në supet e grave dhe këto të lirojnë një pjesë të kohës fizike për t'u angazhuar në veprimtari ekonomike me pagesë. Një tjetër veprimtari që shoqata do ta kryejë në rrjet me organizata të tjera është edhe ofrimi i mbrojtjes ligjore falas grave dhe vajzave, viktimat të dhunës në familje, trafikimit dhe prostitucionit, si dhe ofrimit të mundësive për integrim shoqëror përmes aktivizimit ekonomik.

PALËT KRYESORE TË INTERESUARA NË AXHENDËN “GRATË PAQJA SIGURIA”

Qeveria qendrore:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

Ministria e Mbrojtjes - Akademia e Forcave të Armatosura;

Ministria e Arsimit;

Ministria e Europës dhe Punëve të Jashtme;

Ministria e Drejtësisë;

Ministria e Financave;

Ministria e Brendshme - Shkolla e Policisë;

Kuvendi i Shqipërisë - Komisioni i Sigurisë - Aleanca e Grave në Parlament - Nën-Komisioni i Barazisë Gjinore - Anëtarët e Parlamentit që promovojnë zbatimin e PKV.

Qeveria lokale

Bashkitë, Këshillat Bashkiakë, Njësitë Administrative

Vijueshmëria e punës së ngritur me Koalicionin “Gruaja, Paqja, Siguria” përbërë nga 31 organizata të shoqërisë civile përbën një partneritet të konsiderueshëm për ngritjen e fondeve. Koalicioni u ngrit si një strukturë joformale në kuadër të projektit “Rezoluta 1325, të drejtat e grave nga koncepti në realitetin shqiptar”, financuar nga UN WOMEN, FGE.

4.3 Agazhimi i Shoqatës “Gender, Paqe e Siguri” për mjedisin (Pjesë e Manualit të Procedurave dhe Politikave të Shoqatës)

Shoqata respekton parimet e qëndrueshmërisë mjedisore duke minimizuar ndotjen dhe ndikimin negativ në mjedis si brenda mjedisëve të punës ashtu edhe në aktivitetet e saj. Organizata synon një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm për punonjësit e saj.

Në pikën 4.3 - Politikat dhe procedurat e inventarizimit, pika 4.3.5 - Shkarkimi i materialeve që dalin jashtë përdorimit, do të shtohet:

Nëse materialet janë në gjendje pune, ato dhurohen tek organizata tjetra apo individë në nevojë, sipas një procedure të përcaktuar dhurimi për nxitur ripërdorimin e burimeve të ndryshme.

Gjatë nxjerrjes jashtë inventarit materialet synohet të shkojnë në riciklim.

Pajisjet elektronike brenda zyrës nëse nuk mund të ripërdoren kthehen te shitësi sipas një procedure të caktuar.

- Organizata merr masa për të siguruar efikasitetin e energjisë duke, pa u kufizuar në:

Stafi sigurohet që pajisjet fiken kur nuk është e nevojshme të përdoren apo pas largimit nga zyra; përdorimi i pajisjeve me opsionin screen saver për të kursyer energji, etj.

Në pikën 4.6 - Përzgjedhja, inspektimi dhe dokumentimi i ofruesve të mallrave dhe shërbimeve, pika 4.6.1 - Përzgjedhja e shitësve, do të shtohet:

Partneriteti dhe bashkëpunimi “i gjelbër”:

- Shoqata do të përpiqet të ruajë bashkëpunime me partnerë/ ofrues shërbimesh të cilët ndajnë të njëjtin vizion për kujdesin ndaj mjedisit dhe që promovojnë standard të qëndrueshëm mjedisor për të ndarë njohuri dhe për të bashkëpunuar në projekte të përbashkëta.

- Shoqata do të kujdeset që të sigurojë bashkëpunim me partnerë që ofrojnë produkte cilësore dhe ekologjike, kur është e mundur, jo plastike dhe që mund të ripërdoren, që shmangin paketimet e panevojshme, si dhe ofrojnë pajisje që harxhojnë më pak energji.

- Shoqata do të vendosë kontakte me kompani që merren me riciklimin e mbetjeve (letrës që nuk përdoret në zyrë).

- Blerja e pajisjeve elektronike dhe elektrike, dhe pajisje të tjera të zyrës në kompani të cilat zbatojnë praktika pro – mjedisore.

Në pikën 4.8 Politikat dhe procedurat e transportit, pika 4.8.2 Mënyra të tjera udhëtimi dhe rimbursimi i udhëtimit, do të shtohet:

- Shoqata nxit përdorimin e transportit publik për drejtuesit dhe punonjësit e shoqatës në aktivitetet me distancë të afërt - punonjësit do të lëvizin në këmbë në distancë më pak se 3 km, të cilët do të rimbursohen sipas parashikimit në këtë procedure për lëvizjen me transportin publik.

- Shoqata promovon praktika të përbashkëta të transportit, për të ulur ndikimin në mjedis. Kjo nënkupton që, në rastin e aktiviteteve të përbashkëta, do të bëhet lëvizja me të njëjtën makinë e disa anëtarëve të stafit.

Në pikën 8 – Sjellja në punë, pika 8.1.6 – Dërgimi dhe marrja e mesazheve elektronike, do të shtohet:

- Ruajtja e dokumentacionit elektronik kur nuk është e nevojshme të printohet, mbajtja e shënimeve në laptop sa herë është e mundur

Në pikën 9 - Mbrojtja e mjedisit, pika 9.1.2 – Procedura për minimizimin e ndotjeve, do të shtohet:

- Përdorimi efikas i burimeve dhe zvogëlimi i konsumit të tepërt (zbatuar edhe në dokumentacionin e zyrës): shfrytëzim më i mirë i letrës brenda zyrës (letër më të hollë për printim, printimeve në të dyja anët e letrës; letër e ricikluar për tualetin; përdorim i peshqirëve në vend të letrave

të duarve); shmangia e blerjes së produkteve me shumë paketim; minimizimi i përdorimit të mjeteve/enëve plastike, ruajtja e dokumentacionit elektronik kur nuk është e nevojshme të printohet, mbajtja e shënimeve në laptop sa herë është e mundur; kryerja e online e pagesave për faturat e zyrës, në fund të çdo e-mail të shoqatës do të përdoret shprehja “mos printoni dokumentat në e-mail nëse nuk është e nevojshme”, etj).

- Implementimi i politikave të menaxhimit të mbeturinave që përfshijnë reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve në çdo nivel të organizatës.

- Krijimi i këndit të ripërdorimit të mjeteve brenda zyrës – etiketa, dosje etj; ndarja e mbetjeve brenda zyrës sipas kategorive letër, metal, platishtë, organike.

Në vijimësi të pikës 9.1.2 - Mbrojtja e mjedisit, do të shtohet:

Monitorimi i rezultateve dhe vlerësimi:

- Shoqata cakton një person brenda stafin që shërben si pikë komunikimi dhe monitorimi të objektivave të vendosura, rezultatet dhe arritjet mbi politikën e përcaktuar, si dhe për të vlerësuar dhe identifikuar nevojat për përmirësim lidhur me çështjet mjedisore.

Rritja e vetëdijes dhe edukimit:

- Shoqata do të sigurojë burime informative për të promovuar ndërgjegjësimin e punonjësve dhe përfituesve/ bashkëpunëtorëve mbi çështjet dhe sjelljet pro – mjedisore përmes edukimit dhe promovimit të praktikave pozitive.

Lobim për çështjet mjedisore:

- Shoqata do të krijojë mundësinë për bashkëpunime institucione/ organizata vendore që ndajnë të njëjtin vizion për të ndarë njohuri apo realizuar aktivitete që promovojnë dhe nxisin praktika e sjellje të qëndrueshme pro – mjedisore.

- Shoqata do të marrë pjesë në nisma komunitare mbi çështje që promovojnë mbrojtjen e mjedisit kryesisht në nivel vendor.

V. PLANI PËR NGRITJEN E FONDEVE

Strategjia për ngritjen e fondeve

Ngritja e fondeve është një proces për gjetjen e burimeve mbështetëse për kryerjen e aktiviteteve të planifikuara në strategjinë 5-vjeçare të shoqatës. Burimet që shoqata do të identifikojë për përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të strategjisë janë të diversifikuara. Ato janë burime njerëzore, financiare, ndihma në natyrë, si dhe materiale që shoqata do t'i sigurojë përmes dhurimeve dhe aktiviteteve jo-fitimprurëse. Burimet e identifikuar do të mbështesin edhe ekzistencën e shoqatës, edhe përmbushjen e veprimtarive të saj në dobi të komunitetit të grave dhe vajzave. Gjatë hartimit të strategjisë së shoqatës, u diskutua edhe mënyra e ngritjes së fondeve për aktivitetet si dhe u vendos rradha e aktiviteteve që do të ndërmerren, bazuar në nevojat imediate të grave përfituese dhe në objektivat e shoqatës. Përmes plan-veprimit u planifikua edhe vazhdimësia e projekteve të nisura dhe ndërmarrja e veprimtarive të reja. Idetë për ngritjen e fondeve janë mbledhur në të gjitha takimet dhe intervistat e kryera për hartimin e strategjisë. Edhe në tryezën e prezantimit të strategjisë, u la vend për një diskutim shtesë për ngritjen e fondeve, në të cilin kontribuan thuajse të gjithë pjesëmarrësit. Një ndër idetë më frytdhënëse të tryezës ishte përdorimi më me efikasitet i burimeve lokale në pronësi publike dhe private me justifikimin që ndihma e parë dhe kryesore për pjesëtarët në nevojë duhet të vijë nga vetë komuniteti.

Komuniteti mund të ofrojë ndihmë jo vetëm përmes dhurimeve të ndihmave materiale dhe në para, por edhe përmes angazhimit në punë vullnetare pranë shoqatës. Ri-aktivizimi i punës vullnetare konsiderohet si një nga rrugët më efikase të vetëndihmës në komunitet.

Përgjatë viteve të fundit ka një reflektim në rritje për rëndësinë e vullnetarizmit që po pasqyrohet gjerësisht edhe në media. Gjithësesi, shumica e iniciativave kanë qenë private dhe jo të koordinuara dhe më së shumti janë organizuar nga institucionet publike si shkolla, bashkia, ushtria në mbrojtje të mjedisit. Shoqatat e kanë pasur të vështirë të mobilizojnë njerëzit në aksione vullnetarizmi, pasi thirrjet e tyre kanë rënë në veshë apatikë.

Edhe pse vullnetarizmi është një nga asetet më me vlerë, shoqata ka nevojë edhe për asete financiare për të qenë në gjendje të funksionojë, për të financuar veprimtaritë vullnetare, për të bërë publik aktivitetin e saj, për të paguar shpenzimet për bazën materiale të fushatave ndërgjegjësuese dhe shërbimeve ndaj përfituesve, për të paguar qeranë e zyrës, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj. Ngritja e fondeve është e ngjashme me planin e biznesit i cili duhet bërë çdo vit.

Strategjia e ngritjes së fondeve i duhet shoqatës së paku për dy arsye: e para, shërben si një udhërrëfyes për shoqatën për gjetjen e burimeve dhe e dyta, i duhet paraqitur donatorëve që këta të kuptojnë se strategjia është e shoqatës dhe jo e bërë posaçërisht për donatorët. Kjo strategji bashkëshoqëron strategjinë për zhvillim të shoqatës dhe planin e veprimit. Aktivitetet kryesore përgjatë 5-vjeçarit 2023-2027 janë parashikuar në formë sintetike në projekt-buxhet. Në përgjigje të aktiviteteve të planifikuara do të hartohen edhe projektet përkatëse.

Për zbatimin e veprimtarive të shoqatës, u mbledhën shumë ide nga pjesëmarrësit **nëpër takime**, të cilat kishin të bënin me ngritjen e fondeve. Lista e mëposhtme paraqet një përmbledhje të ideve kryesore për financimin e projekteve të ardhshme të shoqatës (për detaje të SWOT për çdo qëllim referoju Shtojcës bashkëngjitur).

Fondet për aktivitete

Objektivi	Veprimtaria	Burimet
Rritja e përfaqësimit politik të grave	a) Mbështetja për gratë kandidate në zgjedhje	a) Organizimi i një mbrëmjeje bamirësie me personalitete të qytetit.
Fuqizimi ekonomik i gruas	b) Punësimi i grave në nevojë c) Mbështetje sipërmarrjes private	b) Hapja e një fabrike buke dhe pasticerie si biznes social. c) Financimi i materialeve për punë artizanale për: veshje, çanta, zbukurime shtëpiake dhe ekspozim. d) Hapja e bizneseve të vogla: bare, fast-food, bistro. e) Mobilizimi i mësuesve në pension si vullnetarë edukimi për fëmijët e grave

		kryefamiljare.
Ndihmë shoqërore për gratë e varfëra	d) Mbledhja e parave për ndihmë ekonomike dhe ndihmë me ushqime dhe veshmbathje	f) Organizimi i ditës së dhurimit në shkolla ku fëmijët dhe mësues sjellin ushqime, veshmbathje dhe para për familjet e varfra. g) Dhurimi i një libri për një shok/shoqe në nevojë.
Lufta kundër dhunës në familje	e) Shërbim falas psiko-social dhe ligjor për gratë e dhunuara	h) Shitja e luleve në ditë të zakonshme dhe ditë festash nga studentë vullnetarë nëpër auditore, institucione dhe mjedise publike. i) Koncerte për mbledhje fondesh me nxënës të shkollës së muzikës.
Zbatimi i axhendës kombëtare Gruaja Paqja Siguria	f) Monitorimi i axhendës GSP dhe informimi i shoqërisë mbi arritjet e saj në Shqipëri g) Zbatimi i duhur i Rezolutës 1325/Planit Kombëtar të Veprimit nga institucionet përgjegjëse; h) Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për GSP	j) Mbajtja e kontakteve me UN dhe kërkimi për donatorë të tjerë që kanë interes në zbatimin e Rezolutës dhe axhendës GSP. k) Kërkim individual për mundësitë e financimit të aktiviteteve të Koalicionit nga anëtarët individualë të Koalicionit dhe kordinimi i gjetjeve të tyre me Koalicionin. l) Aplikimi i përbashkët nga anëtarë të Koalicionit për zbatimin e Rezolutës. m) Aplikimi nga Koordinator i Koalicionit. n) Identifikimi i rrjeteve rajonale dhe ndërkombëtare të fokusuara në Gratë, Paqe, Siguri. o) Anëtarësimi në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare.

		<p>p) Pjesëmarrja aktive në aktivitetet e rrjeteve rajonale dhe ndërkombëtare.</p> <p>q) publike/ komunikimi i jashtëm</p> <p>r) Rritja e vizibilitetit të Koalicionit.</p> <p>s) Standartizimi i paraqitjes së Koalicionit tek palët e interesuara në GSP (letra me kokë, shkrimi i letrave dhe raporteve, etj.)</p> <p>t) Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve promocionale për Koalicionin.</p> <p>u) Sigurimi i përfaqësimit i duhur dhe dinjitoz të Koalicionit në publik (në aktivitete publike, në media, në takimet me palët e interesuara, në takimet ndërkombetare, etj.), bazuar në Rregulloren e Brendshme.</p> <p>v) Krijimi dhe përdorimi i vazhdueshëm dhe efektiv i mediave sociale të personalizuar për Koalicionin- Facebook, Instagram, Twitter- për promovimin e Koalicionit dhe aktiviteve të tij.</p>
--	--	---

Strategjia e ngritjes së fondeve do të rishihet çdo vit për të vlerësuar edhe sasinë e burimeve të siguruar dhe ato që nevojiten. Për hartimin e strategjisë është përdorur dhe do të vijojë të përdoret analiza e faktorëve: SWOT (Strengths, Weaknesses , Oppurtunities, Threats) dhe PEST (Politik, Ekonomik, Social, Teknologjik) dhe analiza e aktorëve STAKEHOLDERS (Matrix). Një pamje e thjeshtuar e analizës SWOT për kapacitetin e shoqatës për veprimtaritë e planifikuara jepet më poshtë, por në fakt, çdo objektivi i strategjisë 5-vjeçarë është analizuar përmes faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që kanë ndikim domethënës tek aktivitetet e synuara të shoqatës.

SWOT për aktivitetin e shoqatës

	Faktorë pozitive	Faktorë negative
Faktorë të brendshëm	<p>Pikat e forta</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shoqata ka një skuadër të kualifikuar • Shoqata ka një drejtim të mirë • Shoqata ka marrëdhënie të mira me autoritetet vendore: qark, këshill, bashki • Shoqata ka emër të mirë në publik • Koalicioni është i gatshëm për të monitoruar zbatimin e PKV. • Grupet tematike të përkushtuara brenda koalicionit. • Koalicioni ka ekspertizë lidhur me fushat prioritare. • Disa nga organizatat anëtare kanë përvojë dhe ekspertizë në monitorim, avokim dhe lobim dhe ndërgjegjësim. • Përbërja e Koalicionit. • Organizimi i Koalicionit. • Pjesa dërmuese e anëtarëve të Koalicionit janë aktiv. • Grupi i të rinjve të Koalicionit-aktiv. 	<p>Pikat e dobëta</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shoqata ka kontakte të pamjaftueshme me ofrues potencialë burimesh • Shoqata ka një projekt të papërfunduar në dorë. • Shoqata nuk ka kryer ende një vlerësim të jashtëm për arritjet e deritanishme • Fonde të kufizuara që mundësojnë realizimin e aktiviteteve të shumta që lidhen me funksionimin e Koalicionit. • Aktivizimi jo i njëjtë i anëtarëve të koalicionit.
Faktorë të jashtëm	<p>Mundësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ka interes publik për misionin e shoqatës dhe aktivitetet e saj • Po ngrihen biznese te reja në zonë që mund të ndihmojnë • Legjislacioni në çështjet gjinore është favorizues për shoqatën • PKV për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit është në fuqi dhe është 	<p>Kërcënimet</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullat e fitimit për biznesin (social) mund të ndryshojnë si pasojë e reformave në ekonomi • Bizneset fitimprurëse janë shumë agresivë në treg dhe konkurrojnë fort biznesin social të shoqatës • Përvojat e këqija lidhur me zbatimin e strategjive

	<p>miratuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i grupit Ndërinstitucional me përfaqësuesit e Ministrive të linjës; • Nevoja për shërbimet e Koalicionit (për iniciativa avokimi në zbatimin e PKV, në nivel qendror dhe lokal, për Planet e Veprimit në nivel lokal, etj.); • Ndërgjegjësimi i publikut lidhur me GSP është më i mirë se në të kaluarën.; • Ka informacione dhe aktivitete ndërgjegjësimi. • OSHC-të luajnë një rol aktiv në ndërgjegjësimin e publikut. • Në nivel kombëtar, mediat po luajnë një rol të mirë (krahasuar me mediat ne nivel lokal) në lidhje me GSP. 	<p>kombëtare.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mungon informimi dhe ndërgjegjësimi publik, sidomos në zonat rurale.; • Nivel i ulët i vetëdijes së komunitetit.; • Indiferenca e njerëzve ndaj çështjeve që ata mendojnë se nuk ju përkasin.; • Mungesa e seminareve dhe tryezave teknike për ndërgjegjësim.; • Promovim/vizibilitet i kufizuar nga OSHC-të. ; • Materialet promovuese nuk kanë qenë gjithnjë efektive, nuk janë përshtatur për grupe të ndryshme (të rinj, të rritur, etj.).] • Media, sidomos lokale, nganjëherë luan rol negativ, nuk përcjell siç duhet mesazhin, nuk mbulon aktivitetet në se nuk ka figura publike. • Niveli i programeve televizive ka rënë. Nuk ka spote promociionale në lidhje me GSP. • Pushteti vendor i papërgatitur për të zbatuar PKV: Zyrat e Informacionit nuk funksionojnë. Faqet e internetit nuk përdoren shpesh/siç duhet Buxheti i ulët Burimet njerëzore dhe kapacitetet janë të ulëta Njësitë Administrative nuk kanë staf. • Në nivel qendror, bashkëpunimi mes institucioneve është i kufizuar
--	---	---

Për të hulumtuar faktorët e jashtëm me ndikim në ngritjen e fondeve është kryer edhe analiza e faktorëve PEST (faktorë politik, ekonomik, social dhe teknologjik). Këta faktorë nuk janë në varësi të shoqatës dhe shoqata nuk ka ndikim në ndryshimin e tyre, por shoqatës i nevojitet t'i njohë sepse ata kanë ndikim tek veprimtaria e shoqatës. Më poshtë jepet një sqarim ilustrues se çfarë nënkupton secili faktor:

- Politik:** Çfarë ndikimi do të kishte programi i qeverisë tek legjislacioni për biznesin, gjë që prek biznesin social të shoqatës që është ngritur për të punësuar gratë në nevojë, si për shembull furra e bukës që do të punësonte gratë e papuna;
- Ekonomik:** Çfarë ndikimi do të kishte financimi i veprimtarive vullnetare tek financat e shoqatës, si për shembull angazhimi i mësuesve pensionistë për përkujdes passhkollor për fëmijët e grave kryefamiljare ose angazhimi i studentëve si vullnetarë për mbledhje fondesh;
- Sociale:** Çfarë ndikimi do kishte në punën e shoqatës ndryshimi pozitiv i qëndrimeve të publikut ndaj dhunës, a duhet shoqata të ndryshojë veprimtarinë për ndërgjegjësimin e publikut për dëmet e dhunës?;
- Teknologjike:** Çfarë ndikimesh do të kishin risitë teknologjike tek puna e shoqatës dhe tek përdorueset e shërbimeve të saj?

Ashtu si për SWOT-in, shoqata ka hartuar nga një PEST për çdo qëllim, objektiv dhe madje edhe aktivitet të shoqatës. Më poshtë jepet një shembull i analizës së faktorëve të jashtëm PEST nga një aktivitet konkret i shoqatës: Mbrojtja ligjore falas për gratë e dhunuara.

PEST: Mbrojtja ligjore falas për gratë e dhunuara.

Faktori	Ndikimi
Politik	Si do të ndikojë tek mbrojtja ligjore falas strategjia vendore për shërbimet sociale? A do të parashikohet partneritet me shoqërinë civile në hartimin e strategjisë vendore të shërbimeve sociale për gratë e dhunuara? A do të hartojnë njësitë e qeverisjes vendore marrëveshje bashkëpunimi me shoqatat për hartimin e strategjive vendore të shërbimit social, ku shoqatat përfaqësohen në cilësinë e ofruesit të shërbimit apo të përfituesit të shërbimit?
Ekonomik	A do të planifikojë bashkia/qarku buxhet për shërbime sociale në komunitet dhe a do të financohen shoqatat nga buxheti vendor për ofrim shërbimesh komunitare? A do të marrin pjesë shoqatat në tenderimin e shërbimeve komunitare si operatore shërbimi social?
Social	Cili do të jetë efekti i përshkallëzimit të mëtejshëm të dhunës në familje dhe çfarë ndikimi do të ketë tek puna e shoqatës? A duhet shoqata të përshtase aktivitetet e parashikuara?
Teknologjik	Si do të ndikojë teknologjia tek puna e shoqatës për raportimin e rasteve të dhunës dhe ndërgjegjësimin e publikut për efektet negative të dhunës; po tek

	përdorueset e shërbimit ligjor falas si do të ndikojë teknologjia? A do munden viktimat e dhunës të përdorin teknologjinë për t'u informuar dhe raportuar kërcënimet për dhunë?
--	---

Çdo aktivitet i planifikuar mund të zërthehet në një projekt-propozim ku të parashikohet edhe fondi përkatës. Të gjitha projektet do përmblihen në një dokument të vetëm i cili përbën edhe fondin e projekt-propozimeve dhe apo planin e detajuar të ngritjes së fondeve. Është e pamundur në këtë dokument strategjik 5-vjeçar të shoqatës të parashikohen projektet e posaçme për realizimin e çdo aktiviteti të planifikuar, pasi projektet përfaqësojnë anën teknike të zbatimit të strategjisë. Aq më tepër, që projektet janë shume të kushtëzuara nga rrethana kontekstuale dhe kohore, të cilat nuk mund të parashikohen në imtësi në një dokument strategjik si ky. Gjithësesi, në linja të gjera, aktivitetet kryesore të shoqatës janë përlogaritur në projekt-buxhetin e strategjisë së shoqatës, bashkangjitur këtij dokumenti.

VI. BUXHETI

Shoqata Gender, Paqe e Siguri
Pasqyra e aktiviteteve 31 Dhjetor 2022

Shpenzimet e paraqitura sipas funksionit:

Përshkrimi i zërit	2022	2021
Ndryshimi në aktivet neto të pakufizuara:		
Të ardhurat:	5,960,802	6,190.963
Te ardhura nga tarifat e anetaresimit		
Te ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare		
Te ardhura nga grantet qeveritare apo nga agjenci te tjera te financimit	5,960,602	6,19D,963
Te ardhura nga investimet apo dhurimet		
Tarifat per sherbimet		
Te ardhura nga aktivitetet tregtare		
Te ardhura te tjera		
Totali i te ardhurave nga aktivet neto te pakufizuara	5,980,602	6,190.963
Aktive neto të cliruara nga kufizimet:		
Realizimi i kufizimeve të programit		
Realizimi i kufizimit për blerjen e pajisjeve		
Përfundimi i kufizimit të afatit		
Totali i aktiveve neto të cliruara nga kufizimet	0	0
Totali i të ardhurave nga aktivet neto te pakufizuara:	5,960,602	6,190.963
Shpenzime për aktivitetet		

Strategjia e Shoqatës Gender Paqe Siguri 2023-2027

Aktiviteti A (Awen Social Center for Wonen and Girls)	-2,985.174	-3,635.121
Aktiviteti B (AWEN - Earthquake)	0	-
		3,307.232
Aktiviteti C (AWEN - UW)	-62,910	-586,230
Aktiviteti D (Swiss Contact C4E Coaching for Employment & Entrepreneurship funds 2019)		
Aktiviteti E (Seeiss Contact C4EE Coaching for Employment & Entrepreneurship)		
Aktiviteti F (FCG Sweedish Development Strengthening Community Policing in		
AL4iviteti G (UW - Ndhime per grate me problemne sociale e le prekura nga termeti)	-3.003.316	-1,470,684
Aktiviteti G (MinisterieVan Buittenlandse Zaken)	-164,203	-91.257
Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme		
Krijim dhe rritje fondesh		
Totali i shpenzimeve	-6,215,603	-9,9090,524
Rritja/Rënia në aktivet neto të pakufizuara (A)	-255,001	-2,899,561
Ndryshimi ne aktivet neto te kufizuara:		
Kontributet		
Te ardhurat nga investimet afatgjata		
Fitimi i realizuar dhe i parealizuar nga investimet afatgjata		
Humbja aktuariale nga obligacioni vjetor		
Aktivitet neto te cliruara nga kufizimet (me shenje minus)		
Rritja/Rënia ne aktivet neto perkohesisht te kufizuara (B)	0	0
Ndryshimi ne aktivet neto (A + B)	-255,001	-2,899,561
Aktive neto në fillim të vitit	298.495	3,198.056
Aktive neto në fund të vitit	43,494	298.495

BIBLIOGRAFIA

- Agolli, M., A. Plaku and E. Danaj, 2011. Integrimi – rasti i migrimit të brendshëm në Shqipëri. Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Programi i Promovimit të Kërkimit në Ballkanin Perëndimor
- Instituti i Statistikës (INSTAT), 2013, Femra dhe Meshkuj në Shqipëri
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2013) Rezultatet e Zgjedhjeve 2013, buletin online aksesuar: ne URL <http://result.cec.org.al> dt 12.01.2014
- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPCSSHB), 2007, Strategjia Kombëtare për barazinë gjinore dhe dhunën në familje 2007-2010
- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPCSSHB), Strategjia Kombëtare për barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje, 2011-2015

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPCSSHB), Strategjia Kombëtare e përfshirjes shoqërore

Republika e Shqipërisë, Ligji “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare” nr 9669, datë 18.12.2006

Republika e Shqipërisë, Ligji “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” nr.9970, datë 24.08.2007

Republika e Shqipërisë Ligji “Për mbrojtjen kundër diskriminimit” nr.10221, datë 04.02.2010

Republika e Shqipërisë Ligji “Për Ndihmën dhe shërbimet shoqërore” nr. 9355, datë 10.03.2005

United Nations Women (UNWOMEN), 2011, Raporti Kombëtar i Pozicionit të Grave dhe i Barazisë Gjinore në Shqipëri

SHTOJCAT

Shtojca për shërbimet

Ushtrimi 1: ANALIZA SWOT E KAPACITETIT TË SHOQATËS

FAKTORË TË BRENDSHËM	
Pikat e forta	Dobësitë
<ol style="list-style-type: none"> 1. Eksperinca ndër vite 2. Fuqizimi konkret i përfituesve nga projekti 3. Modeli pozitiv, përvoja të mira të stafit 4. Aftësi dhe kapacitete informuese dhe ndërgjegjësuese 5. Anëtarësi me gra të motivuara 6. Rezultate te matshme dhe raporte transparente 7. Eksperiençë në hartim, zbatim, menaxhim projekti 8. Krijimi i një rrjeti të gjerë bashkëpunuesish 9. Gëzojme besueshmëri dhe vizibilitet në komunitetet ku veprojmë dhe tek institucionet e tjera 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mungesa e mediatizimit të punës 2. Mungesa e gazetarëve si pjesë e stafit qoftë edhe part-time 3. Mungesa e eksperiencës në ngritjen e fondeve për vetëfinancim
FAKTORË TË JASHTËM	
Mundësitë	Kërcënimet
<ol style="list-style-type: none"> 1. Mbështetje nga institucionet e 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mjedisi politik patriarkal, ekzistenca e

<p>pushtetit vendor</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. Ndërgjegjësim ndaj fenomenit të dhunës në rang shoqëror, institucional ose rritja e ndjeshmërisë sociale ndaj fenomenit në fjalë. 3. Ndjeshmëri e donatorëve ndaj fenomenit 4. Media, shoqëria civile. 5. Ekzistenca e politikave apo strategjive kombëtare dhe rajonale me fokus dhunën në familje dhe çështjet gender. 6. Vullneti politik, ngritja dhe ekzistenca e strukturave të veçanta institucionale publike mbi çështjet gender dhe dhunën në familje. 	<p>mendësisë patriarkale në tërësi</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. Ekzistenca e miteve ndaj OJF-ve në media, politikë si të orientuara drejt fondeve më shumë se ndaj fenomenit. 3. Mungesa e shërbimeve mbështetëse efektive si shkolla, çerdhe etj për rehabilitimin e grave të dhunuara të cilat duan të punojnë dhe të bëhen të pavaruara 4. Mungesë kapacitetesh në burime njerzore në institucionet mbështetëse publike, ndryshimi i shpeshtë i punonjësve si shkak i ndryshimeve politike 5. Mungesa e qëndrueshmërisë politike në kapacitete në burime njerzore.
--	--

	SHGPS	Pushteti vendor dhe institucione te tjera vendore	Media	Shoqëria Civile dhe OFJ te tjera simotra	Komuniteti dhe institucione të tjera educative/shëndetësore, politike, etj
SHGPS	1. Identifikim i viktimave dhe nevojave të tyre 2. Minimizim i pasojave psikologjike 3. Mbrojtje ligjore dhe psikologjike 4. Informacion mbi procedurat ligjore 5. Të punohet me agresorin për luftimin e problemit në rrënjë	1. Implementimin e procedurave ligjore për mbrojtjen, trajtimin e viktimës dhe ndalimin e dhunuesit. 2. Akses në burimet financiare apo shërbimet sociale që ekzistojnë për viktimat 3. Ndihmë në riintegrimin e viktimës në jetën e re pa agresorin	1. Evidentimin e rasteve për syrin e opinionit të gjerë publik 2. Rritje të vizibiliteteit të organizatës dhe shërbimeve të saj	1. Ofrim i shërbimeve të tjera shpesh si psh strehim	1. Ofrim i ndihmës mjeksore ndaj viktimës 2. Bashkëpunim në rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë ndaj fenomenit 3. Bashkëpunim në lobimin për ndryshimin e ligjeve
Pushteti vendor dhe institucionet e tjera vendore	1. Ndihmë në identifikimin e viktimave 2. Ndihmë në plotësimin e shërbimeve të ofruara ndaj viktimës dhe familjes (psikologjike, strehim, etj)	Zbatimin e çdo procedure ligjore që lidhet me mbrojtjen, trajtimin, riintegrimin e viktimës dhe familjes së saj dhe dhunuesit.	1. Bashkëpunim në pasqyrimin e punës së tyre, shërbimeve që mund të ofrojnë këto institucione 2. Informacion mbi mundësinë e aksesit në shërbime publike	1. Bashkëpunim në plotësimin e boshllëqeve në shërbimet e ofruara nga pushteti vendor apo institucione të tjera publike. 2. Bashkëpunim në sensibilizimin e shoqërisë ndaj fenomenit	
Media	1. Informacion mbi fenomenin, pasojat, vështirësitë në luftimin e tij 2. Informacion mbi shërbimet që ofron shoqata		1. Pasqyrim i fenomenit, natyrës, shkak-pasojë, shërbimeve parandaluese, trajnuese, rehabilituese apo mungesave në këto shërbime. Burimeve të ofruara të shërbimeve	1. Bashkëpunim në sensibilizimin e shoqërisë ndaj fenomenit 2. Burim informacioni	Bashkëpunim në sensibilizimin e shoqërisë ndaj fenomenit
Shoqëria Civile dhe OFJ të tjera si motra	1. Bashkëpunim për ofrimin e shërbimeve plotësuese 2. Rrjet për lobim 3. Bashkëpunim për sensibilizimin dhe			1. Plotësimi i shërbimeve të ofruara ndaj viktimës me anë të shërbimeve të tjera shpesh .	Bashkëpunim në sensibilizimin e shoqërisë ndaj fenomenit

Shtojca MATRIX I AKTORËVE KRYESORË

Ushtrimi 2 Matrix- i i aktorëve.

Grupi 1

	SHGPS	Zyra Barazisë Gjinore Bashki	Shteti, Policia, Gjykata	Avokati i Popullit	Media
SHGPS		Strehë identifikim		Ndjekje rasti	Sensibilizim Trajnim mediave
Zyra Barazisë Gjinore Bashki	Shkëmbim përvojash Parashtrim i rasteve konkrete		Mbrojtja (UMM) Ndjekje monitorim Seancë gjyqësore		
Shteti, Policia, Gjykata	Parashtrim i rasteve konkrete Ndhima e parë	Koordinim Bashkëpunim Masa ndaj agresorit	Ngritja e ekipeve multidisiplinore apo qendra rehabilitimi		
Avokati i Popullit	Paraqitjen e rasteve				
Media					

Grupi 2

Shtojca SWOT FUQIZIMI EKONOMIK

Ushtrimi 3: FUQIZIMI EKONOMIK I GRUAS

Analiza SWOT:

FAKTORË TË JASHTËM	
Pikat e forta	Dobësitë
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kapacitet për rritjen e ndërgjegjësimit rreth kësaj teme 2. Arsimimi, kualifikimet, përvoja e stafit në këtë fushë 3. Eksperienca në vitet e kaluara 4. Ekzistenca e një database për personat në nevojë në lidhje me këtë qëllim 5. 4 projekte në këtë fushë të përkrahura 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mungesë marketimi 2. Mosorientim drejt biznesit por rreth problemeve sociale, mungesa e përvojës në të menduarin si biznes 3. Mungesë eksperience në ngritje fondesh 4. Ndryshimi i stafit

dhe nga EU.	
FAKTORË TË JASHTËM	
Mundësitë	Kërcënimet
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kuadër pozitiv mbi strategjinë dhe ligjet 2. Interes nga donatorët e huaj dhe vendas mbi temën 3. Shoqëri arsimdashëse 4. Ndërgjegjësim i grave për të fituar pavarësinë 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Legjislacioni ndëshkues mbi OJF-të 2. Mungesa ose pamjaftueshmëria e shërbimeve mbështetëse si cerdhe, kopshte për gratë të cilat duan të vetëpunësohen apo të punësohen.

A. Shtojca për pyetjet për intervistat dhe fokus-grupet

Pyetësor për vlerësimin e gjendjes së barazisë gjinore dhe dhunës në familje

Ky pyetësor u përdor për intervistime dhe fokus grupe me gra përfituese të veprimtarisë të shoqatës dhe anëtare të bordit të shoqatës, stafit dhe bashkëpunëtorë të tjerë.

Rubrika 1: Barazia gjinore në veprimtaritë ekonomike

1. Cilat mendoni se janë arsyet e varfërisë femërore në zonën tuaj?
2. Çfarë mendoni se është bërë mirë deri tani për të adresuar çështjen e varfërisë tek gratë dhe vajzat?
3. Çfarë mendoni se duhej të ishte bërë me mirë për të ndrequr pozitën ekonomike të grave dhe vajzave?
4. Çfarë mendoni se duhet bërë në të ardhmen për të përmirësuar gjendjen ekonomike të grave dhe vajzave?
5. Çfarë mund të bëjë shoqata për të lehtësuar fuqizimin ekonomik të grave në zonën tuaj?

Rubrika 2: Barazia gjinore në vendimmarjen publike

1. Cilat mendoni se janë arsyet e mospjesëmarrjes së grave në jetën politike në zonën tuaj?
2. Çfarë mendoni se është bërë mirë deri tani për të adresuar çështjen e përfaqësimit të grave dhe vajzave?
3. Çfare mendoni se duhej të ishte bërë më mirë për të ndrequr pozitën e nënperfaqësuar të grave dhe vajzave?
4. Çfarë mendoni se duhet bërë në të ardhmen për të përmirësuar gjendjen e përfaqësimit të grave dhe vajzave ?
5. Çfarë mund të bëjë shoqata për të nxitur pjesëmarrjen në politikë të grave dhe vajzave në zonën tuaj?

Rubrika 3: Dhuna në familje

1. Cilat mendoni se janë arsyet e dhunës në familje në zonën tuaj?

2. Çfarë mendoni se është bërë mirë deri tani për të adresuar çështjen e dhunës në familje?
3. Çfarë mendoni se duhej të ishte bërë më mirë për të ndrequr shkaqet e dhunës ndaj grave?
4. Çfarë mendoni se duhet bërë në të ardhmen për të minimizuar/zhdukur dhunën ndaj grave?
5. Çfarë mund të bëjë shoqata për të minimizuar/luftuar dhunën ndaj grave në zonën tuaj?